

Dr. Nuhi Veselaj

F J A L O R P U N E

shqip-serbokroatisht

/P o s l o v n i r e ç n i k /

/albansko –srpskohrvatski/

me shtojcë –sa dodatkom:

serbokroatisht - shqip

/spskohrvatski – albanski/

/ për nevojat e uzinës/- /za potrebe fabrike/

“AMORTIZATORËT” - “AMORTIZERI”

- Prishtinë / - Priština

-me theks terminologjia tekniko-teknologjike/

-sa naglaskom tehničko-tehnološka terminologija

Prishtinë, 2017

Recensues: 1. Ymer Bylykbashi, profesor i gjuhës shqipe
2. Hajrulla Simnica, inxh. i dipl. i makinerisë

Përshëndetje,

Lexues i nderuar, ndoshta gjatë konsultimit të këtij FJALOR PUNE të shkon mendja se ke hyrë në një pyll pa rrugica të rregulluara mirë, mos u zhgënje, kujtoje të vërtetën që së paku shëtitja në pyll gjithkuj ia lehtëson frymëmarrjen, ndërsa studiuesit ia freskon trurin.

Sidoqoftë, urime në këtë shëtitje, po nëse ke mundësi ndreq diçka, qoftë me dorë, qoftë me gojë.

Autori

Prishtinë, 2016

Fjalor pune – poslovní rečník

TRYEZA E LËNDËS

Përshëndetje

Përmbajtja

Vlerësimi i recensuesve

Nga prof. Ymer Bylykbashi

Nga inxh. Hajradin Simnica

Parathënie

Treguesit alfabetikë teksti shqip-serbokroatisht faqe

A

B

C

Ç

D

DH

E

Ë

F

G

GJ

H

I

J

K

L

LL

M

N

NJ

O

P

Q

R
RR
S
SH
T
TH
U
V
X
XH
Y
Z
ZH

Numri i treguesv sipas zërave e nënzerave, versioni shqip-serbokroatisht
Shtrojçë teksti serbokroatish - shqip version i shkurtuar sipas treguesve
alfabetikë, faqe

A
B
C
Č
Ć
D
Dž
Đ
E
F
G
H
I
J
K
L
Lj
M
N
NJ
O
P
R
S

Š
T
U
V
Z
Ž

Pasthënie ose episod rreth vetes e historikut me të veçantat e këtijn Fjalor
pune

Literatura kryesore

Të dhëna biblio-biografike për autorin

MENDIMET E RECENSUESVE

1) Nga prof. Ymer Bylykbashi

Për të shkruar recensionin ose për të shprehur mendimin tim për veprën e dr. Nuhi Veselajt me titull **Fjalor pune shqip-serbokroatisht me shtojcën serbokroatisht shqip, me theks terminologjia tekniko-teknologjike**, hartuar për nevojat e zbatimit të dygjuhësisë në Uzinën e Amortizatortëve të Prishtinës /*Poslovni rečnik albanski–srpskohrvatski - sa dodatkom srpskohrvatski – albanski - za potrebe dvojezičnosti Fabrike Amortizera – Priština*), /*sa naglaskom tehničko-tehnološka terminologija*/ , e pranova me kënaqësi dhe me njëfarë sidetyrimi kolegial, ngase me njohjen e paksa me grumbullimin e lëndës së kësaj natyre (fjalorit dygjuhsor) fillimisht e gjejë veten si pjesëmarrës, madje edhe para z. Nuhi, që në fillim vitet '70 të shekullit të kaluar, ndërsa isha punësuar të punoja në atë Fabrikë si gazetar e redaktor i gazetës *AMORTIZERI* dhe ndërkohë kalova edhe si lektor-përkthyes së bashku me kolegun Nuhi Veselaj. Mirëpo pas një kohe pasi qeshë larguar nga ajo ndërmarrje, mesa pashë, Nuhiu, përveç atij materiali intern që kishim jo voluminoz dhe më fort në versionin serbokroatisht – shqip, kishte përfshirë e sistemuar edhe material tjetër të risjellë e plotësues, duke e përzgjedhë qoftë nga përvoja në punë të përditshme përkthimesh në këtë Uzinë, qoftë të vjelë nga fjalorë të tjerë profesionalë. Dhe kështu, Nuhiu kishte bërë një punë vërtet të madhe jo vetëm për atë uzinë, por që mund të vlerësohet si kontribut edhe për ndërmarrje të tjera metal-përpunuese, por edhe përgjithësisht në këtë fushë. Ç'është e vërteta, në këtë dorëshkrim-përmbledhje, vetëm në versionin shqip serbokroatisht ndeshim të mbarështruara afro 8000 (tetë mijë) fjalë-terma, të radhitur në afro 5000 zera dhe mbi 3000 nënzëra. Të gjitha emërtimet janë shifruar dhe sistemuar alfabetikisht me barasvlerës përkatës në gjuhën serbokroate. Në tekst siç pritej për nga numri mbizotërojnë fjalë-termat nga fusha e terminologjisë tekniko-teknologjike që ndërlidhen ekskluzivisht me ndërmarrjet metalpërpunuese, siç është konkretisht Uzina e

Amortizatorëve të Prishtinës, që ishte e vetmja e këtij lloji në Ballkan dhe ndër të rrallat për prodhimtari mjaft rentabile në Europë. Në të vërtetë, në këtë *Fjalor pune*, janë përfshirë edhe edhe mjaft fjalë-terma nga fusha të tjera jo ekskluzivisht nga fusha tekniko-teknologjike, por që nuk janë pa interes dhe që dosdomosdo i duhen përkthyesit të çdo ndërmarrjeje prodhuese e joprodhuese e sidomos atyre me veprimtari me teknologji të zhvilluar.

Ç'është e vërteta, vlera praktike e këtij *Fjalori pune* për kohën kur u hartua nuk mund të mohohet, ngase zbatimi i dygjuhësisë, (pra edhe i gjuhës shqipe) si e drejtë kushtetutare në KSAK edhe në saje të përkthyesit Nuhi Veselaj, në Uzinën e Amortizatorëve ishte në nivelin e duhur, madje ky shembull ka ndikuar edhe në ndërmarrje të tjera, sepse ky Fjalor, i shaptilografuar pati efektin e vet, ngase u shpërnda anembanë ndërmarrjeve e institucioneve përkatëse, andaj tash nëse do të botohet kështu edhe më i përpunuar dhe zgjeruar, sigurisht do t'u hyjë në punë jo vetëm punëtorëve shqiptarë, por edhe atyre të kombeve e kombësive të tjera, madje do të jetë ndihmesë edhe për studiuesit e të interesuasit përkatës në mënyrë që për çështje të caktuara terminologjike nga fusha tekniko –teknologjike të gjenden më lehtë pas konsultimit edhe të këtij fjalori.

Sido që të jetë, ky *Fjalor pune* i dr. Nuhi Veselajt nga ana jonë vlerësohet lart dhe si i tillë patjetër duhet të libertohet, ngase do të jetë i mirëpritur jo vetëm nga punonjësit e punëtorët e Uzinës së Amortizatorëve, por edhe për të gjitha ndërmarrjet metalpërpunuese në Kosovë e më gjerë, por njëherazi do të jetë e mirëseardhur edhe për studiuesit e hartuesit e fjalorove të tjerë e sidomos të atyre të terminologjisë teknike shkencore të të dyja gjuhëve e në veçanti për ata të gjuhës shqipe.

Prof. Ymer Bylykbashi, ish-lektor-përkthyes,

Prishtin, 19.07. 2003

2) Nga Hajredin Simnica, inxh. i dipl. i makinerisë

Ndonëse nuk kam përvojë në recensionimin e librave e aq më pak të fushës së leksikografisë, por për veprën e Nuhi Veselajt “*Fjalor pune*” e mora për sipër për të dhënë vlerësimin tim, ngase jam i njohur pak a shumë konkretisht me këtë veprimtari të z. Nuhi.

Në vitet 70 - 80 të shekullit të kaluar në Fabrikën e Amortizatorëve të Prishtinës e kryeja postin e drejtorit të Njësisë punuese “**Prodhimi**”. Ishte periudhë entuziazmi jo vetëm për ne inxhinierët e sapodiplomuar shqiptarë, por edhe për diplomantë të tjerë juristë, ekonomistë, gjuhëtarë-përkthyes e të tjerë, që donim ta jetësonim në praktikë edhe shqipen si të drejtë dygjuhësie të sansionuar me Kushtetutën e KSA të Kosovës, pra edhe si gjuhë pune, prodhimi, por hasnim në vështirësi, shqipja si gjuhë shkrimi më përpara, por edhe tash ende nuk e kishte primatin përpunimit zyrtar që të mund të dilte gjithkund si e barabartë, sepse serbishte vinte e trashëguar zyrtare si gjuhë administrative dhe si gjuhë e prodhimit të drejtpëdrejtë. Kështu që në këtë drejtim shqipja më fort ishte e dëshirueshme, sidomos e kam fjalën sa i përket gjuhës teknike konkrete në elaborate e dokumente të punës etj.

Sidoqofte, me angazhimin e përkthyesit, Nuhi Veselaj të sapopunësuar gjetëm një mënyrë të duhur konsultimi, besa edhe mësimi e lehtësimi që të fillonim me të praktikuarit të zbatimit të dygjuhësisë edhe në procesin e prodhimit të drejtpëdrejtë, në dokumentet përkatëse rreth urdhëresave të punës etj. Kështu në të vërtetë edhe unë si shokët isha i njohur praktikisht me një pjesë të lëndës së fjalorit të tillë intern të përgatitur nga përkthyesi, Madje edhe e kemi pasë organizuar si tryeza diskutimi me kolegë e me përkthyesin kryesisht rreth terminologjisë teknike që nuk e kishim të harmonizuar. Një formë e tillë bashkëpunimi na pati ndihmuar shumë në konsolidimin e termave e të shprehjeve që nevojiteshin për zbatimin e dygjuhësisë, sidomos tek punëtorët shqiptarë e serbë që ishim të përfshirë së bashku në prodhim të drejtpëdrejtë dhe shërbehehsin me dokumentin e njëjtë në të dyja gjuhët. Kështu për të parën here filloi zbatimi me sukses te ne edhe i gjuhës shqipe në të gjitha sferat e jetës e të veprimtarisë në kuadër të Uzinës së Amortizatorëve të Prishtinës. Kjo ishte meritë e kohës, por edhe meritë e z. Nuhi me të cilin konsultoheshim, ashtu siç konsultoheshim edhe ai, jo vetëm me stafin inxhiniero-teknik, por edhe me

punëtorë të përfshirë në prodhim të drejtpërdrejtë, dhe kështu me sa ishin në dijeni autori përveç konsultimit të burimeve të caktuara profesionale edhe në këtë mënyrë në konsultim me ne e punëtorët mblidhte e grumbullonte materialin përkatës, të cilin ndërkohë edhe e pati shumëzuar me shaptilograf si fjalor intern, të cilin e pati shpërndarë brenda Fabrikës (punëtorëve serbë e shqiptarë), por edhe jashtë.

Në të vërtetë, këtë gjendje e kishim pak para ngjarjeve, kur punëtorët shqiptarë u përjashtuan nga procesi i prodhimit në këtë Fabrikë dhe pastaj ndodhën ngjarjet të tjera që sollën edhe Luftën Çlirimtare të Kosovës 1998-1999

Në të vërtetë, pas Çlirimit, pas vitit 1999, kur bashkë me punëtorët u rikthyem në vendet e punës, ndërsa z. Nuhi ishte në pension, edhe unë, si tërë stafi drejtues si dhe drejtori i përgjithshëm Gani Dauti, ishim iniciatorë që puna rreth Fjalorit në fjalë të riaktivizohet, andaj pas dy tri vjetësh e ftuam pensionistin dr. Nuhi Veselaj ta sistemonte lëndën nga dorëshkrimi që e kishte të përgatitur më parë, ngase donim tash ta kishim si libër, sepse e vlerësonim si tejet të dobishëm. I përdornim disa nga termat që pak a shumë i kishim të konsoliduar më parë.

Sidoqoftë, Nuhiu edhe pse i pensionuar pranoi ta kompletonte dorëshkrimin, të cilin e dorëzoi në drejtori të kompjuterizuar, por tash priste kompensimin me libërtimin e tij, siç i kishte premtuar drejtori i përgjithshëm dhe drejtori i kuadrove, por mjerisht, kjo nuk u realizua, pasi veprimtaria nuk shkoj mbarë kësaj Uzinë, siç e quante përkthyesi. Ndërkohë Ndërmarrja me emrin Fabrika e Amortizatorëve falimentoi, dhe si pasojë fjalori mbeti në zyrën e drejtorisë së ndërmarrjes pa u libërtua, por si me thënë shpëtoi, duke mbetur si shenjë e mirë me vlerë të veçantë për ta kujtuar atë Uzinë.

Ç'është e vërteta, Fjalori përveç që përmban shumicën e termave që edhe lidhen ose lidheshin me proceset tekniko-teknologjike që zhvilloheshin në uzinën tonë përmban edhe fjalë-terma të tjerë, të cilët mendoj se nuk prishin punë aspak, ngase shfrytëzuesit mund t'i hyjnë në punë në ndërmarrje të tjera prodhuese e joprodhuese, por njëherazi lënda e këtij Fjalori mund të shërbejë edhe për kulturë të përgjithshme.

Në fund shpreh mendimin që Fjalori si i tillë duhet të botohet, sa më parë, ndërsa autori gjithsesi meriton falenderim e mirënjohje edhe nga qarqet shoqërore- kulturore dhe akademike-shkencore shqiptare e më gjerë.

Prishtinë, nëntor 2005

Parathënie

Ky **Fjalor pune** ka zanafillën që në vitet '70 të qindvjetëshit që sapo e lamë pas, kur pas disa veprimeve të dhunshme nga pushteti i atëhershëm qeshë i detyruar të punësohem si përkthyes i dygjuhësisë serbisht –shqip në NP “Amortizatorët”- Prishtinë. Dhe menjëherë fillova me grumbullimin e materialit, mirëpo ky material paksa u rumbullakësua në filimvitet '80, kur doli versioni i parë i shaptilografuar i tij, lëndë kjo e cila u përplotësua ndërkohë deri në vitin 1990. Fillimisht i patëm shënuar vetëm fjalë-termat më të nevojshëm për punët dhe detyrat nga vendi i punës së përkthyesit në atë ndërmarrje prodhuese metalpërpunuese, por që njëherazi kishim vizionin që materiali i tillë të shërbente për të lehtësuar sadopak zbatimin e dygjuhësisë, jo vetëm në shërbimin e administratës, por në të gjitha fushat e veprimtarisë dhe të jetës në uzinën në fjalë dhe më gjerë. Sigurisht kishim parasysh edhe nevojat e dëshirën e punëtorëve në prodhim të drejtpërdrejtë, me qëllim që edhe te ata (klasa punëtorë) e drejta e dygjuhësisë (serbokroatisht - shqip) e ligjëruar sipas Kushtetutës së atëhershme të Kosovës, të zbatohet joformalisht po realisht. Është e vërtetë se për të parën herë edhe dokumentacioni i punës, si: *plani ditor i veprimit, udhëzimet, dëshmitë, urdhëresat, skicimet, elaborimet tekniko-teknologjike etj.*, filluan të bëheshin e të zbatoheshin sipas formularëve edhe në gjuhën shqipe. Mirëpo, synimi ynë nuk mjaftonte me kaq, ishte edhe më i gjerë. Themi “*edhe më gjerë*”, ngase e shihnin që një punë e tillë do të ishte me interes të përgjithshëm shoqëror (kombëtar), sepse me probleme të tilla, sidomos me çështje të terminologjisë politeknike-teknologjike, siç kisha njohuri edhe nga shkollat e mesme (ekonomike e teknike), ku kisha punuar më parë, ballafaqoheshin, sigurisht më tepër se që ballafaqohen sot, te ne, në raport me gjuhët e huaja, jo vetëm ndërmarrjet e tjera prodhuese e jo prodhuese, por aq më tepër edhe vetë shkollat profesionale, shkollat e larta po edhe fakultetet. Natyrisht është fjala të institucioneve me mësim në gjuhën shqipe. Këtë e themi me plot gojë, ngase sa punoja në shkolla të mesme (ekonomike, teknike e gjimnaz), edhe dhe në jetën praktike konsultoheshim dhe diskutonim jo rrallë me kolegët e

lëndëve përkatëse tekniko-profesionale, pikërisht për çështje të hapura terminologjike. Prandaj një përvojë e tillë paraprake sadokudo më ndihmoi që të gjindesha jo aq me vështirësi edhe në *vendin e ri të punës – përkthyes në ndërmarrje metal-përpunuese*, por edhe të konceptoja, si me thënë, më drejtë edhe specifikën e problemeve që i ndeshnim tani konkretisht në Uzinën e Amortizatorëve të Prishtinës, të cilat duheshin zgjidhur. Ç’është e vërteta, ndihmë të pakursyer fillimisht pata nga kolegu prof. Ymer Bylykbashi, i cili edhe më përpara, duke punuar për gazetën *Amortizatorët* e në aktivitete të tjera në këtë uzinë, kishte fituar përvojë, qoftë në grumbullimin e materialit specifik të nevojshëm, qoftë në gjetjen e barasvlerësve përkatës në gjuhën shqipe. Gjithashtu, po në gjetjen e ekuivalencave adekuate, pos materialit të vjelë nga fjalorët përkatës të terminologjisë tekniko-shkencore të kohës, patëm ndihmesë të konsiderueshme, të domosdoshme ballafaquese, edhe nga vetë personeli entuziast inxhiniero-teknik shqiptar i punësuar në këtë organizatë punonjëse metalpërpunuese. Ndër ta si më të dalluar mund të përmendim zotërinjtë; Islam Metaj e Avdi Limani, inxhinierë të diplomuar të makinerisë, madje z. Islam Metaj, edhe pse pati kaluar me punësim gjetiu, nuk e ndërpreu bashkëpunimin me mua rreth përplotësimit (verifikimit) të materialit përkatës të këtij *Fjalor pune*. Është e vërtetë se në janar të vitit 1981, kur Fjalori si me thënë, mori njëfarë fizionomie, duke u pasuruar me lëndë të re të vjelë, qoftë nga ndonjë burim vendës, qoftë nga ndonjë tekst nga Shqipëria, pasi vetëm atëherë na u dha njëfarë mundësie të konsultonin ndonjë tekst teknik prej andej. Në të vërtetë ky dorëshkrim fjalori si tekst i shaptilografuar, siç u cek më sipër, u shpërnda, jo vetëm në kuadër të ndërmarrjes, por edhe më gjerë. Atëbotë iu ofrua afro 100 individëve intelektualë autoritativë të kohës (në fakultete, institute dhe organizata të tjera punonjëse), ku veç tjerash, duke shfrytëzuar e respektuar specifikat e caktuara, kërkohesh prej tyre vërejtje, plotësim dhe diskutim të lëndës sipas këtyre fushave semantike:

1. emërtimet e njësive të *punës dhe të formave të tjera të organizimit të punës*;
2. emërtimet e *njerëzve sipas profesionit, sipas vendeve të punës, kualifikimit shkollor-profesional dhe sipas kiarëkisë shoqërore etj.*;
3. emërtimet a *termave teknike që kanë të bëjnë me emërtimet e mjeteve të punës, aparateve, perdorësve, por edhe emrat e pjesëve*

përbërëse të mjeteve të punës;

4. emërtimet e të gjitha proceseve të mundshme teknologjike si dhe

5. emërtime të tjera me interes nga të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë (juridike, ekonomike, gjuhësore etj.).

Pikërisht një konceptim i tillë i çështjeve na ndihmoi që krahas plotësimit të Fjalorthit përkatës, ne të shtronim në diskutim publik çështje teorike të përgjithshme e të veçanta praktike të natyrës së tillë, duke botuar artikuj, punime, trajtesa deri ndërkohë edhe monografi të veçanta, të cilat arritën me dhjetra e dhjetra për nga numri, punë kjo që është vlerësuar si kontribut me vlerë jo të vogël në gjuhësinë shqiptare, sidomos në atë kohë. Meqenëse atëbotë, siç dihet, mbizotëronte administrata në gjuhën serbokroate, serbishtja, si me thënë, për ne ishte *lingua franca*, ishte normale dhe politikisht më i lejueshëm që hartimi i fjalorit të bëhej në versionin serbokroatisht - shqip, por ne, si me thënë, edhe pse fillimisht i kishim të shënuara së pari termat në serbisht, për hartimin e Fjalorit u pozicionuam për versionin shqip - serbokroatisht, madje e kishim në vizion tipin e fjalorit shifror me gjuhë themelore shqipe. Pra dëshirën që na flinte për zemër, e pëlqyem si me thënë guximtarisht, pikërisht ashtu siç do të ndodhë ajo që duhej të ndodhte, tash pas mëse 20 vitesh, kur teksti shqip si tekst parësor zyrtar do t'u ndihmojë serbokrotishtfolësve (sot: serbëve, kroatëve, boshnjakëve (muslimanë), goranëve, romëve e të tjerëve, si dhe shumë shqipfolësve të pasprovuar me terminologjinë shqipe) që së pari të konsultojnë fjalë-termat e nevojshëm parësorisht nëpërmjet gjuhës shqipe. Ç'është e drejta, ne pjesërisht kishim filluar ta bënim që atëherë versionin shqip-serbisht, kështu e patëm shaptilpgrafuar edhe versionin e parë në vitete '80, mirëpo kjo punë dhe tërë procesi i hartimit dhe i libërimit mbeti i pambaruar për arsye se në fillim të viteve '90, kolektivisht u përjashtuan nga puna të gjithë punëtorët shqiptarë, andaj edhe Fjalori, i tëri mbeti dorëshkrim. Pastaj ndodhi edhe Lufta UÇK 1998-1999, kur punëtorët shqiptarë u kthyern në vendet e punës.

Në të vërtetë në, vitin 2003, tani, pas katër vjetësh nga rikthimi i punëtorëve tanë në punë, në korrik të atij stafi drejtues i kësaj uzine me në krye drejtorin e përgjithshëm, tash të ndjerë, Gani Dauti, duke ndjerë nevojën e terminologjisë politekniko-teknologjike shqipe në raport me gjuhë të tjera, shtruan nevojën e riaktivizimit të punës rreth fjalorit në fjalë. Edhe pse isha në pension pasi më ftuan, sigurisht edhe tani, në kushte të reja, por me ideale e qëllime, pothuajse, të njëjta, e pashë të arsyeshme të rimotivohem dhe ta kryejë punën rreth përgatitjes me kompjutorizimin e

fjalorit, duke e bërë rradhitjes e lëndës sipas alfabetit etj. Natyrisht bëra edhe ndonjë përmirërim a përplotësism rasti. Gjithsesi u përpoqëm në mënyre që materiali i tillë të ishte i gatshëm për libërtim dhe kështu ta shohë dritën e shtypit. Por e keqja edhe më e madhe ndodhi, me që uzina si e tillë bojkotoi, pushoi së vepruari, atëherë edhe ky Fjalor pune mbeti pa u libërtuar.

Sidoqoftë, fundja ne bëmë punën tonë, edhe këtë punë e konsideruam, sikur veprat e tjera tona të mbetura dorëshkrim, andaj vendosëm me e libërtue, duke qenë të bindur se përkundër ndonjë lajthitjeje a mospërfshirjeje, ngase tani jo vetëm se nuk jemi në rrjedha të drejtpërdrejta të terminologjisë së tillë përkatëse, kur edhe procesi i veprimtarisë së asaj uzine ka pushuar, atëherë ky fjalor mbeti së paku si një prove me rëndësi dokumentare. Sido që të jetë, ky *Fjalor pune* nga aspekti praktik e profesional na merr mendja se edhe kështu si është do të shërbëjë për të mirë, jo vetëm për vetë punëtorët ndërmarrjeve të ngjashme në fjalë që u dedikohet, por edhe më gjerë, sidomos do t'u hyjë në punë të interesuarve për ta njohur, sadokudo, jo vetëm përpjekjen e gjeturinë tonë në ato rrethana të caktuara kohore, por edhe për ta vlerësuar e shfrytëzuar lëndën e regjistruar në të mirë të kulturës ose të konsolidimit të mëtejshëm të terminologjisë në përgjithësi, por edhe të asaj tekniko-teknologjike në gjuhës shqipe në veçanti.

Njëherazi do të dëshironim që kjo punë jona të joshë dhe të sfidojë punonjësit e tjerë, kolegë tanë, që të nxjerrin në shesh vlerat e tyre të këtij lloji, që mund t'i kenë. Kur themi kështu kemi parasysh faktin se atëherë edhe në ndërmarrje të tjera prodhuese, joprodhuese e përgjithësisht në të gjitha organizatat shoqërore-politike, punonte një armatë e tërë *lektorësh*, përkthyesish e redaktorësh, të cilët mbase do t'i kenë hartuar atëherë, si ne, "fjalorët e vet specifikë". Nxjerrja në dritë e një pune të tillë do të ishte ndihmesë jo e vogël për administratën tonë të sotme, por edhe për shqipen standarde në lëmenjtë e caktuar përgjithësisht, duke u inkorporuar kështu njëherazi si lëndë e ofrueshme për fjalorët e rij përkatës në kuadër të leksikografisë sonë.

Në fund, shfrytëzojmë rastin që recensuesit e sidomos vlerësuesit e kësaj vepre t'i falenderojmë përzemërsisht.

Prishtinë, nëntor 2016

Autori

Treguesi alfabetik i termave shqip - serbokroatisht

A

1. Abazhur (kapuç llambe) - abažur (senilo lampe).
2. Abezator /lëshues/ - upuštač.
3. Ablender – ablender.
4. Abrogim (shfuqizim) – abrogacija, ukidanje, poništenje.
5. Aberracion (ravgim) – skretanje, odstupanje.
6. Absorbim (përthithje) - absorbcija.
7. Abuzim (shpërdorim) – zloupotreba
8. Acidifikim (thartëzim) - zakisilevanje
Acidim (thartim) -kiselovanje
9. Aerometër – aerometar.
10. Aderim – pristupanje, zahvaćenje
11. Administrim - aministriranje, upravljanje;
adminstrimi i provave – izvodjenje dokaza.
12. Adresar (emëror) telefoni - telefonski imenik.
13. Afatore – rokovnik, terminer.
14. Afri - srodnost;
afërsi – afinitet;
afrimi i materialit - dotur meteriala;
afruesi i marterialit - dopremač materijala;
afrueshmëri - pristupačnost.
15. Aftësi - spretnost, moć, sposobnost, umešnost;
aftësi përthyesë – moć prelamanja;
aftësi rrotulluese - moć obrtanja;
aftësim i kuadrove - osposobljavanje kadrova.
16. Agrafe (mbërtheckë) – kopca, spoj.
17. Agushi – zapara;
tym i agushtë - zagušljivi dim.
18. Ajër - vazduh, zrak
ajër i ngjeshur – kompromirani vazduh
ajrim - provetravanje;
gyp ajrimi - ventilaciona cev;
ajrim shtytës - potisno provetravanje.

19. Akaparues (parablerës) – nakupac, prekupac.
20. Akceptues – akceptant, prihvatanik.
21. Akopjim (puthitje, qiftëzim) – priljubljenje.
22. Akordim - uskladjenje, odešavanje;
akordim bobinash - regulisanje kalema;
akordim (dhënie) i kredise – davanje (dodelivanje) kredita.
23. Akrep /shigjetëz – kazaljka.
24. Aks (bosht) - osovina, osa;
vijë boshtore - osovinska linija;
akse te kithta - mimiolazne ose.
25. Akselerator (per/shpejtues, shpejtësor) – ubrzač, ubrzivač.
26. Akt - čin, postupak, radnja, akt;
aktkontroll - kontrolni list
aktpërfaqësim - mandatni list;
aktvendim - rešenje;
aktmarrëveshje – pismeni dogovor (sporazum);
akttjetërsimi - rešenje o otudjenju.
27. Akumulator – akumulator.
28. Aliazh - legura, smesa.
29. Alarm - uzbuna;
alarmim - alarmiranje;
alarmor – javljač (požara i dr.).
30. Alkool dytësor – sekundarni alkohol.
31. Almise (andri) - alat, pribor, delovi mehanizma.
32. Alternator - alternator;
alternator njëfazor - monofazni alternator;
alternator trefazor - trofazni alternator;
alternator shumëfazor – višefazni alternator.
33. Altoparlant - zvučnik
34. Allçi /gjips - gips, sadra.
35. Ambalazh – ambalaža.
36. Amidon - skrob, štirak.
37. Amiant i platinuar – platinizirani azbest;
amiant pëlhure - azbest platno.
38. Amortizator /zbutësor a fikates - amortizer /ublaživač, prigušivač;
amortizator hidraulik - hidraulčni amortizer;
amortizator me gaz - gasni amortizer;
amortizator me fikSION - fikcioni amortizer;
amortizator hidropneumatik - hidropneumatski amortizer;
amortizator me levë - polužni amortizer;

- amortizator rulor- pertlovani amortizer;
 amortizator i përparmë - prednji amortizer;
 amortizator i sprasmë - zadnji amortizer.
39. Amper- amper;
 amper-dredhë - amper-zavojak;
 amper-percjellës - provodni amper;
 amper shkyqës- aparat za isključivanje.
40. Amplifikator /zmadhues - pojačalo, pojačivač.
41. Amplitude (gjani) - amplituda
42. Ampulë /rëgjezë/ - bočica, posudica od stakla za lekove .
43. Amti – talog; indolencija.
44. Amshti - bezokusnost.
45. Amzë - matrikula, matična knjiga;
 amëz-fletë ose letër dylli, matricë – matrica
46. Ancak – konzola, podupirac struje.
47. Aneks /shtojcë - dogradak, prilog.
48. Anë - strana, bok;
 anasinjal i djathtë - desno migavac;
 anasinjal i majtë - levi migavac;
 anë e pasme - poledjina;
 anasjellë - inverzija, premetanje;
 lakore e anasjelltë – obrnuta kriva.
49. Anëshkrim/margjinë - margina.
50. Angërr – opna, maramica.
51. Anim /anësim, anesë – nagib, kosina, naginjanje, pristrasnost.
52. Anlaser – anlaser.
53. Anomali e rendesës – gravitaciona anomalija.
54. Aparat - aparat, sprava;
 aparat elektroharkor - elektrolučni aparat;
 aparat ndërlidhës - priključni aparat;
 aparat saldimi – aparat za zavarivanje.
55. Aparaturë - aparatura;
 aparaturë e vinçave - dizalični uređaji;
 aparaturë shkencore - naučna aparatura.
56. Apartament - apartman.
57. Aqvlërësi (barasvlërësi) - ekvivalentnost.
58. Ar – zlato;
 prarim - pozlačenje.
59. Aranhues – aranzher.
60. Ardhjevajtje - primicanje-odmicanje.

61. Argasje – izradjivanje, izrada, prekalisanje.
62. Argano /argën, çikrik/ – vitao;
arganist - vitlar.
63. Argoshpuqërrzimi – bubuljica, gnojnica
64. Argjendim – posrebrovanje.
65. Argjilë /deltinë - glina.
66. Arkë - sanduk, kovčeg, kutija;
arkë rikumbimi - rezonantna kutija;
arkë trasporti – transportni sanduk;.
arkëz - sandučić
67. Arkëtim - kasiranje;
arkëtues - inkasant.
68. Arkiv - arhiv;
arkivist - arhivar.
69. Armatesë – podgrada, armatura;
armim – stavljanje armature.
70. Asimptotë /vijëpërkulëse – krivolinijska asimptota.
71. Asnjanësi - neopredelenost;
asnjanësim – neutralisanje.
72. Asortiment – asortiman.
73. Aspirator /thithësor, përthithësor - aspirator, prečisčivač, sisač.
74. Ashkël - strugotina.
75. Ashpëri – hrapavost, neravnost;
ashpërsi - strogost.
76. Athtësim /athëtim – zakiseljavanje.
77. Auspuh për automjete – auspuh za kola
78. Autenticitet –verodostojanstvo
79. Autollamarinist - autolimar
80. Automat - automat, samokret;
automat për drita anësore (anasinjale) – automat za žmigavce.
81. Automekanik – automehanicar
82. Automjet – vozilo;
autobot (autocisternë) - cisterna;
autoofiçinë – autoservis.
83. Autorizim - ovlašćenje, punomoćje
84. Avrohë - ožiljak
85. Avull – topla para, vodena para;
avulli - isparivanje;
avullzim – vaporizacija.
86. Axhustator - adjuster, bravar;

axhustator-mekanik – mašinbravar.
87. Azotim – azotiranje.

B

1. Bagazh - prtljag.
2. Bakërim - bakarisanje.
3. Bakfon – mesing.
4. Balancim /barazpeshim/ - balanciranje.
5. Balestër /fleksion - opruga (za vešanje);
sustë fleksioni – fleksijona opruga.
6. Baltë shtambash /deltinë / - glina;
baltë xeherori – primese ruda.
7. Ballësor, ballë qemeri - glavna fasada, frontespis
8. Ballëz –podstepenik;
ballë qemeri – glava svoda.
9. Ballzinë – nadvratnik.
10. Bandazh /fashë - bandaš, zavoј.
11. Banishtë fabrike – fabrička kolonija.
12. Bankë (tryezë) zdrukthëtarie – stolarski stol.
13. Banjë – kupatilo;
banjë ranore - pešçano kupatilo.
14. Baraslargësi/baraslargesë - jedanako odstoјanje, ekvidistancija.
15. Baraspeshë - ravnoteža;
barazpeshor - stabilizator.
16. Barazim /rrafshim – izjednačenje, јednakost, јednačina, izravnanje.
17. Barazimtari – uravnilovka, egalitarizam.
18. Barazues elektrik - kompenzator.
19. Barbull – šiljak (za čišćenje poluga i dr.).
20. Bardhinë (ngjyrë e bardheme) – belilo (belkasta boja).
21. Barkëzim (i truallit etj.) – ispupčenje, izbočina.
22. Bartës /kapriat (i sustës) – rešetkasti nosaç opruge
23. Bartësor /tra bartës – nosaç, greda prenosnik.
24. Bartje - prenos;
bartje mekanike - mehanička vuča;
bartje e peshave - nošenje tereta.
25. Bartore – nosilјka, nosila.
26. Bast - opklada;

- bastar - kladilac.
27. Bashkëbator (bashkëbërës) – sačinilac, kofaktor.
 28. Bashkëbanim – sustanarstvo, ukučanstvo.
 29. Bashkëboshtor – koaksijalan.
 30. Bashkëdebitor (bashkëdetorës) – sadužnik.
 31. Bashkëdyzim – jedinjenje.
 32. Bashkëkyçës – sukljuçar.
 33. Bashkëlidhëse /xhunto – spojnica.
 34. Bashkëmarrëdhënie – medjusobni uzajamni odnos.
 35. Bashkëpërkim – poklapanje, podudaranje
 36. Bashkëqenie e lëvizjes – koekzistencija kretanja
 37. Bashkësi - skup, zajednica, sklop;
bashkësi e rrëgjueshme – svodljivi sklop
 38. Bashkëvizim – kolineacija;
bosht bashkëvizor – kolinerana osa.
 39. Bashkim – udruživanje, jedinstvo.
 40. Bashkujdi - dogovor.
 41. Bateri amortizimi – prigušna baterija.
 42. Batim - prevrtanje, nagnutost.
 43. Bazë /mbështesë - osnova, osnovica, podloga;
baza e dhëmbzit– osnovica zubca .
 44. Bazhdarim - kalibrisanje;
bazhdar - meraç.
 45. Bendiks anlasera – bendiks anlasera.
 46. Besëtar - pouzdanik
 47. Bërdokull /ntrashje - zadebljavanje.
 48. Bërës – počinilac, činilac.
 49. Bërthamë e shpërntusur - raskinuto jezgro.
 50. Bërryl, bërrylak – kolenacta cev, krivina okuka, zavijutak
 51. Bidon – kanta, limenka.
 52. Biellë (brenë, kaçikëz, pistonetë) – klipnjača, poluga kretača.
 53. Bigë (bigor, bigëzor) - raçva, raçvica, ruda;
bigëzim - raçvanje, grananje.
 54. Bigorr i dhëmbëve – zubni kamenac, krečnjak.
 55. Bilbil /pipëz – pištaljka.
 57. Binar- kolosek, gredica;
binarizëm - dvojnost.
 58. Binde – balon, opletana boca.
 59. Bindje - uverenje;
bindje e verbër – slepa poslušnost.

60. Binjakëzim kristalesh – bližnjenje kristala.
61. Birë (vrinë) mine - minska rupa.
62. Biril– kugla;
biriltore - kuglanica.
63. Biruese – bušilica rupa.
64. Bistur – skalper, nož.
65. Bishtajë - buranije.
66. Bitum/serë - bitumen;
bitumim - asfaltiranje.
67. Bizele - grašak.
68. Bizë - šiljak, šilo.
69. Blatim - rtvovanje.
70. Blind - blind, oklop.
71. Blozë /bramc – çadj, gar, garež.
72. Blozurinë - opiljci.
73. Bluzhdë – mrvica;
bluzhdim - iz/vrvitanje;
bluzhdurinë – strugotine.
74. Bllok /bashkëtërësi – blok, sklop, skup, celina;
bllokim (zhbllokim) i çmimeve - zamrzavanje (odmrzavanje) cena.
75. Bobinë /rrakel/ - kalem, bobina;
bobinë tokëzimi - kalem za uzemljenje,
bobinë ndërçeljeje /komutimi – komutacioni kalem;
bobinë bllokuese - blokirajuća bobina.
76. Bokël - klip (kukuruzni).
77. Bokollza e jashtme shtrënguese – spoljna stezna çaura.
78. Bonbol (bocë) – boca, staklenica.
79. Bonsek /sharrë llamarine/ - lisna bonseka.
80. Bornë /kapëz/ - klema, priključnica.
81. Borsetë - torbica, kesa.
82. Bosht /shpindël/ - vreteno /osovina;
bosht i xhuntos;/ – osa, vratilo, spojnička osovina;
bosht bërrylor /kollodokë - kolenasta osovina;
bosht me shlica – ožljebljena osovina.
83. Botilë (shishe) - staklenica, flaša.
84. Bramc (zgjyrë) - zgura, šljaka.
85. Brande - preklopno postelje.
86. Bravë – brava, ključanica;
bravëpunues - bravar.
87. Bregth /majole – ivica, sic.

88. Brejcë - glodački nozh .
89. Brejtje - korozija (razjedanje, čupanje očupanje);
Brejtje e veshëzës së poshtme – korozija donje ušice.
90. Bremzë - kočnica, zavor.
91. Brenc – strugalja, strugača.
92. Brendatrupëzim – inkorporacija.
93. Brendësi – unutarinjost.
94. Brezarkë, brezar - spojnica, potporni zid.
95. Brez – pojas, pripasač;
brez rrethor – opasač
96. Bri – rog;
bri akustik - zvučna truba,
bri mbrojtës - zaštitni rog.
97. Brizë– grebenaljka, vlačara;
brizim - grebenjanje, vlačenje.
98. Bronë /kapëz - priključnica.
99. Bronzim – bronžiranje.
100. Brushë (furçë) – četka, četkica..
101. Buhavitje – naduvanje, oticanje.
102. Bulnim /pikëtim – kirniranje, obeležavanje.
103. Bulon /dado, mbyllësore – matica, zavrtnj, šaraf;
bulon i valvulës së poshtme - vijak donjeg ventila;
bulon çengel – kukasti vijak;
bulon bazamenti – fundamentalni vijak.
104. Bullungë - ispupčina, kvrga, guka izbačina.
105. Burgji /punto, turjelë - svdlo, bušilo.
106. Burim - izvor;
burim pikësor – tačkasti izvor.
107. Burmë (vidhë) - vijak, zavrtnj.
108. Burthim – izbijanje.
109. Buton - dugme;
buton i ziles – dugme zvonceta.
110. Buzinë /buzinë këmbësore – ivica, bordura, ivičnjak.
111. Bykëzim – pretvaranje u plevu /prosjev.
112. Bymim /zgjerim/ - širenje, rastezanje, diletacija.

1. Cabik /petës – valjak, oklagija.
2. Cak – granica, priključna tačka.
3. Cakë – kvota, porezna stavka.
4. Cakorre – sekirača, dubac.
5. Caktimi i baraspeshimit – iznalaženje (superpozicija) ravnoteže.
6. Caktinë e shfrytëzuar – iskorišćeno polje.
7. Cakule – torbica.
8. Capë, capinë – motika, kopača, capina.
9. Cedim - ustupanje.
10. Cefël – ljusta, iver.
11. Cekje - spominjanje, dotakanje.
12. Celofan – celofan.
13. Cenim – povreda, uvreda.
14. Central - centrala, stanica;
centralist - cenralista, telefonista.
15. Centrim /qendërzim - centriranje.
16. Centrofugë - centrifuga;
pompë centrifuge - centrifugalna pumpa
17. Cep – vrh, ivica, rub, ugao.
18. Certifikatë - uverenje.
19. Cëmbim – bodkanje.
20. Ciflosje - cepkanje;
ciflim - raskidanje.
21. Cik - rub, ivica (od posude).
22. Cikasje – tačkanje.
23. Cikalosje - šarenje tačkicama.
24. Cikël – ciklus, kružni proces.
25. Cikël hysterioze – petlja histereze.
26. Cilësi – svojstvo, kakvoća, kvalitet.
27. Cilindër – valjak, oblica, stubljina;
cilindër bashkësi /bllok/ me flegra - cilindar sklop sa ventilima;
cilindër goditës - udarni cilindar;
cilindër tejbartësor dysHEMEJE - podnivljak transporter;
cilindër përshkimor – provlačeni cilindar.
28. Cimak – pipalo, antena, bodljika.
29. Cimbidh /mashë/ – kleštice, štikaljka, mašice;
cimbidhje - štipanje.
30. Cilore (sofrabez) - stolnjak.
31. Cipë /vëmesë, cipal – nomotač, sloj opna, membrana.

32. Cipëz, cipë /shtresë kontakti – opnica, kožica.
33. Cirkë – kap, kapljanje,
cirkël - mrlja, kapljica
34. Cisternë - cisterna, nakapnica
35. Citim – navodjenje, citat
36. Ckëlfitje /ciflosje/ – ogrebotina, raspadanje emajla (laka).
37. Copë – komad, parçe, deo;
copurina - parčad;
copëtim - komadanje;
copëzim - drobljenje, usitnjavanje.
38. Cufël – pahuljica.
39. Cungim - skračenje.
40. Cukël– odpadci /vune i svile;
Cuklim, cuklurina - pucvalt.
41. Cungal - podupirač.
42. Cupil - poprečnica, podmetač.
43. Curril, – kladence;
currilor - mlaznica.
44. Cytje - podsticanje, podbadanje, draženje.
45. Cythje – pelcovanje, štipanje.

Ç

1. Çaçkë – šolica (za kavu).
2. Çagjë /blozë – gar, garež, čadj.
3. Çakëll (guri) - tucanik, šodra.
4. Çakullim – odledjivanje, odmrzavanje.
5. Çalë – nabor (bora).
6. Çallapatisje – izgužvanje.
7. Çallatë - pukotina, krnja od sećiva.
8. Çallë – pukotina
9. Çakmak - upaljač
10. Çamak – mačuga, podupirač.
11. Çanak - kalenica
12. Çandër /tërthorak, cfurkë, pajandër– podupirač, potporač, kosnik,
prečka.
13. Çangë - gong.
14. Çangël – kuka;

- çangël sigurie - sigurna hvataljka.
15. Çantë - tašna.
 16. Çapalisje - grickanje.
 17. Çarje – pukotina, prorez;
 çarje shpetëzimi - pukotine sloja,
 çarje /zgalë/ fërkimi- prslina, breča trenja.
 18. Çartë - zavada.
 19. Çastësi - trenutačnost, momentalnost.
 20. Çavullim ([avullzim)– devaporizacija.
 21. Çekan - čekič;
 çekan brame largues – čekič za čišćenje zgure;
 çekan druri - čuk;
 çekanim - čekičanje;
 çekiç - maljica.
 22. Çekth – oštrica, sečivo, kljun.
 23. Çelës - ključ, prekidač, dugme, odvijajač, odvrtač;
 çelës pirun sonde – bušotinski sondni ključ,
 çelës vetëveprues - automatski prekidač,
 çelës uji /saraçineskë/ - ustava;
 çelës kopil - kalauz, otpirač;
 çelës ballor – cevasti ključ,
 çelës universal – francuski ključ;
 çelësabërës – ključar, bravar.
 24. Çelje – otvaranje, raširenje.
 25. Çikërrim - isitničenje;
 çikërrimtoe – bakalnica.
 26. Çikrik - vitao, čekrk, dizalica, kolotur.
 27. Çelik - čelik;
 çelik i derdhur – čelični liv;
 çelik shpejtprerës – brzorezni čelik;
 çelik i lidhur – legirani čelik;
 çelik karbonik – ugljeni čelik;
 çelikanë (uzinë çeliku) – čeličana.
 28. Çelikran – kosira, kosijer.
 39. Çelitje – popravljanje.
 40. Çengel - kuka;
 çengel për varje - kuka za vešanje.
 41. Çep – slavina, kljun, grlo.
 42. Çerçivë – oplata, okvir prozora.
 43. Çerdhe – gnezdo, jaslice.
 44. Çernier ose sharnjer – zglob, šarka /tehnička/.

45. Çift - par;
çift force ose çiftforcë – spreg sila;
çift vektorësh - vektorski par;
çiftëzim – sprega.
46. Çimentim – cementiranje.
47. Çivi – šarka, baglama.
48. Çjerrmë – poderica, poderotina.
49. Çlirëti – labavost.
50. Çlirim - oslobodjenje, oslobadjanje;
çlirim gazi (ngrohtësie) – izlučivanje gasa (toplote).
51. Çlyrësim /çyndyrëzim – odmaščivanje.
52. Çmim - cena;
çmimor /lista e çmimeve/ - cenovnik.
53. Çmontim – rasklapanje, demontaža, rasklop.
54. Çmprehje – otupljenje, zatupljenje.
55. Çmuarje - poštovanje, cenjenje.
56. Çndemje – raširenje, razvlačenje.
57. Çndryrje – otključivanje.
58. Çndryshkëzim /bajcëzim/ - bajcovanje.
59. Çomangë /topuz - buzduvan, batina sa glavom.
60. Çrrasje – istrgnuće.
61. Çrrënjosje – iskorenjenje.
62. Çurg - mlaz;
çurg hypës – izlazeća /polazna/ struja;
çurg uji – struja (mlaz) vode
63. Çycë - čep, grlo (od posuda).

D

1. Dado /kundërvidhë – matica /navrtka, matica vijka;
dadokurorë – krunasta navrtka;
dado e valvulës së poshtme – navrtka donjeg ventila.
2. Daktilografim – odkucavanje, kucanje, tipkanje.
3. Dalje – izlazak, ispusni otvor;
dalje e zinxhirit - ispuštanje lanca;
dalëz – ispupčenje.
4. Daltari /skulpturë – vajarstvo;
daltim - klesanje.

5. Daltë – dleto, dubac seçivica;
 daltëdore – ručno dleto;
 daltë e lakuar – savijeno dleto;
 daltë spirale – spiralno dleto;
 daltë fyle - perfirirano dleto;
 daltë katrore – četvrtasto dleto;
 daltë këndore - kutno/uglato dleto;
 daltë kryqe – krstaško /križno dleto;
 daltë kurore - vjenačno /krunasto dleto;
 daltë lugore – lopatasto dleto;
 daltë majuce - šiljato dleto;
 daltë me diamant – dijamansko dleto;
 daltë me vana/ulluqe – dvožlebno dleto;
 daltë me kokë të ndërrueshme – dleto sa izmenjenom glavom;
 daltë në formë shtize – koplasto dleto.
6. Dallim – razlika, diferencija.
7. Damar - ile.
8. Dash hidraulik – hidraulična pumpa.
9. Daullë /tambur – bubanj, goč.
10. Darë- klešta.
11. Debutim (paraqitje) - nastup.
12. Deduktim – izvodjenje.
13. Deformim – unakaženje, izobličavanje.
14. Degëzim – račvanje, razdvajanje;
 degëzim bobine – odvod kalema;
 degëzim i harkuar – ručno račvanje;
 degëzor pozicional /stellues – štelovana račva.
15. Degë – grana, područje; struka, odsek, odelenje, podružnica.
16. Dell /fill, tel – žila, žica;
 dell i pykëzuar – isklinjena žila;
 dell-shtresë – slojna žila;
 dell tërthor – poprečna žila;
 dellëzim – žilavost, nervatura;
 degë delli - prožiljak.
17. Dekalcifikim /zhgëlqerëzim - dekalifikacija.
18. Dekantim – taloženje, dekantiranje;
 dekantor /dekantuesor – dekantor dekantator.
19. Deklaratë - izjava.
20. Dekret-ligj - uredba.
21. Dekompozim /shpërbërje - rastavljanje, rasščlanjivanje.

22. Dendësi - gustina, zgušjavanje;
dendëshori – glomaznost, nezgrapnost;
dendësim – gustina, kompaktnost;
dendësi kubike – zapreminska gustina.
23. Denduri (shpeshti) - zgusnutost, učestalost;
dendurimatës - frekventometar.
24. Deng – bal.
25. Denoncim /i kontratës - prijava, otkazivanje ugovora.
26. Depërtim – probijanje;
depërtueshmëri – pronicljivosrt, propustljivost.
27. Depo – skladište, magacin.
28. Deponim - iskaz, svedočenje.
29. Depozitë mallrash – uskladištenje robe.
30. Derstilim – valjanje.
31. Derdhazë – izliv;
derdhje – liv;
derdhje metali – izlivanje metala;
derdhëtore – livnica.
32. Derdhje- dalje /shpenzimi/ e mjeteve financiare - priliv - odliv
finansijskih sredstava;
derdhës, shkrirës, gizëtar - livac.
33. Derë kryesore – glavna kapija, glavna ulazna vrata;
derëz – vratanca, prilazna vrata;
derës, derëtar, portier – vratar, portir.
34. Derivat /prejardhës/ - izvod, derivat;
derivim – izvodjenje, derivacija, nalaženje izvoda.
35. Destinacion – upotreba, namena.
36. Destinim – namena, svrha predodredjenja.
37. Detaj-derdhës - odlivak,
detaj farkëtues /prokat - odkivak.
38. Detajet e makinës – delovi mašine;
detaj bazor – osnovni element
39. Detektim /zbulim – detekcija;
dedektor /zbulor, zbuluesor – detektor /otkrivač.
40. Detonator - detonator, kapsula.
41. Detyresë – dug;
pagimi i detyresës – plaćanje duga;
detyrës – dužnik.
42. Dezhur /kujdestar, ditor – dežurni
43. Dëbim – odbacivanje;

- dëbimi i rondelës – odbacivanje podmetača;
dëbues/or – izbacivač, odbojnik;
dëbues gome – gumeni odbojnik,
dëbues plastik – plastični odbojnik;
forcë dëbuese – odbojna sila.
44. Dëftesë - priznanica, svedočanstvo, svedodzba;
dëftesë ngarkimi – tovarni list.
45. Dëftues (dëftuesor) - eksponent, indikator, indeks, kazalac.
46. Dëgjimi (marrje në pyetje) i dëshmitarit - saslušanje svedoka..
47. Dëkim /rrënxim - kilavost.
48. Dëm /dëmtim - ošteta /oštećenje.
49. Dërgesë postare – poštanska uputnica /mandaposta.
50. Dërgim rryme – emitovanje struje;
dërgim impulsesh - emitovanje impulsa;
dërgimi i sendeve – slanje stvari;
51. Dërmëhasje – rasbacivanje.
52. Dërrasë – daska;
dërrasim – drvena oplata, oblaganje;
dërraskë parketi – parketna daščica.
53. Dëshirë - želja, volja.
54. Dëshirim - prohtev.
55. Dëshmi /provë– dokaz;
dëshmim i të ardhurave – iskazivanje dohodtka;
provë dëshmimi - dokazni postupak.
56. Dështim – pobačaj, podbačaj.
57. Diamant – dragi kamen.
58. Diagram – dijagram;
diagram mbitrusnie – dijagram nadpritiska.
59. Diametër – prečnik, promjer.
60. Diellishtë /dielltore – sunčalište;
diellzim – osunčavanje.
61. Dietë /pagëtyrë - dnevnic, dnevnic i putni troškovi.
62. Digresion /shmangie - odstupljenje, digresija.
63. Diferencim - diferenciranje.
64. Difraksion – ogibanje.
65. Difuzion /shpërhapje – difuzija.
66. Dikim – slivanje, pritok.
67. Diktimim – apelovanje, kasacija.
68. Dilatometër /matës zgjatimi - dilatometar.
69. Diletant – nestručnjak.

70. Dimension /përmasë – dimenzija, razmer.
71. Dimnishtë - zimnište.
72. Direk - jarbol, stub;
direku i parmë – prednji jarbol;
direku i prapmë – zadnji jarbol, stub.
73. Direktivë /udhëzim – upustvo, smernica;
direktrisa – provodnik, direktrisa.
74. Dirigjim /përdrejtësim – upravljanje.
75. Disk – ploča, diskos.
76. Dislokim /zhvendosje - dislokacija.
77. Dispeçer /shpërndarës – rasporedjivač.
78. Disponim - raspoloženje.
79. Dispozicion - raspolaganje.
80. Disenjator /disenjues - crtač, skicer.
81. Disfavorizim – nepovoljnost.
82. Difraksion – ogibanje, difrakcija.
83. Disocim /shpërbashkim - raspad.
84. Distançë – raspon, razmak, odstojanje
85. Distilim - prečiščavanje;
distilor - distilator /sprava/.
86. Ditar – dnevnik,
ditar pune a veprimësie - poslovni dnevnik.
87. Ditëpune – radnidan, truddan.
88. Divergjencë – razmimoilaženje
89. Dizgjni – dizgni, vodjica, povodac.
90. Djegë – opekotina.
91. Djegie /përndeze– zapaljenje, izgorenje.
motor me djegie të brendshme - motor sa unutrašnjem sagorevanjem;
djegshmëri /djegie - zapaljivost, sagorevanje, pregorovanje
92. Djegurinë /lëndë djegëse, karburant – gorivo;
djegurishtë – z/gorište, ogarina.
93. Djep i skelës - ljujka.
94. Dobësim – malaksanje;
dobësim i disiplinës – popuštanje discipline.
95. Dobi – korist, dobitak.
96. Dokumentarist-kopjues – dokumentarista-kopirant
97. Dokumentim – dokazivanje.
98. Dollap – plakar;
dollapët shpërndarës – razvodni ormari.
99. Domosdoshmëri - neophodnost, neminovnost.

100. Domkë – oteklina, guka, kvrga.
101. Donor (elektrona) – davac elektrona.
102. Doracak – priručnik.
103. Dorak /manivelë - drška klipna poluga, ručica, držalo/ krivaja
104. Dorashkë /dorezë – rukavice; ručica, kvaka, drška;
dorezë akordimi – drška za štimovanje;
doreza mbrojtëse – zaštitne rukavice.
105. Dozim – doziranje.
106. Dragë /dhenxjerrëse (ekskavator) – bager, gliboder.
107. Dredhë /pështjellëz - zavojak, navoj, vijuga, uvojnica, okuka;
dredhje - uvijanje savijanje, obrtanje;
dredhës /dredhor – razvrtač;
dredhëti – vijugavost, krivudavost.
108. Dredhor /dredhës – vinkler, zavijač;
dredhësor – razvrtaljka.
109. Dredhule – vihor, vazdušni vrtlog.
110. Drejtboshtor – pravoosni, ortoaksionalni.
111. Drejtëz ballore – frontalna prava.
112. Drejtim – pravac, smer.
113. Drejtorat – direkcija, odelenje
114. Drejtpeshim – ravnoteža.
115. Drejtreshitim – postrojavanje.
116. Drejtues – upravnik, poslovodja, upravitelj.
117. Drejtuese – direktrisa, linija vodilja.
118. Drejtuesor /regullator, drejtues – ispravljач /struje
119. Drenazhim – drenažiranje.
120. Dreser /ushtrues – dreser, ukratilac.
121. Dridhërimë – drhtavilo, drhtavica
122. Dridhës /oscilator – vibrator;
dridhjematës - vibrometar,
dridhjeshkrues – vibrograf.
123. Dridhje përdredhëse – torziona vibracija.
124. Dritë – svetlost;
dritëz - svetiljka, kandilo.
125. Dritësor - obasjavač, osvetljivač.
126. Dromcë /thërime – trunaka, trošica;
dromcim - razdrobovanje.
127. Drugë /drugë, meqik, sovajkë – čunak, cevniak; vreteno, druga,
preslica.
128. Drunjëzim - odrvenjenje.

129. Drushtë – stub, bandera, stativa.
130. Dry /pllackar – katanac, lokat;
drynim /ngujim– zaključavanje.
131. Duarlarëse /sqoll - umivaonik.
132. Duç / lëfytez - slavina, čep.
133. Dukje /pamesë – izgled, pogled.
134. Dukuri - pojava;
dukje e rrejshme – lažna prividnost;
dukshmëri - vidljivost.
135. Duresë /tolerancë – tolerancija;
shmangie e lejueshme - dopušteno odstupanje.
136. Dybazëti – dvobaznost.
137. Dyboshtor /dyaksor - dvoosni;
kristal dyboshtor – dvoosni kristal.
138. Dyfishim – odvostručenje, dupliranje;
dyfishor /dyfishues – dubler
139. Dyllë – vosak;
dyllë i kuq /gumullak – šelak, crveni vosak;
dyllosje – voštenje.
140. Letër-dylli /paus/ - pauspapir, matrica.
141. Dymëzim - dvostručenje;
dysi – dvojstvo;
Konstruktor – kontruktues

Kontra matrica – kundërdado
Kontrolnik – vegël kontrollimi, kontrollor
Kontrolni cep – kalibër tapë
Kopir-strug – torni kopjues
Kota (dužinske) – kuota zgjatore
Kotlarnica – kaldatore
Kotur - makare
Kovanje – farkëtim
Krivulja – kurba
Kučište zaptivke – shtëpiza e hermetizuesit
Kuglični ležajevi - kushinetat sferike rrokullisëse

L

Lak (izolacioni) – vernik izolues
Lančanik – rul zinxhiror
Lemilo automatko/ elektricko – pikje (me kallaj): automatike/elektrike
Lemljenje – pikje, ngjitje
Leplivo - lëndë veshtullore
Letkon - pikësor
Levak - hinkë
Letva - flugëz
Ležiste – kushinetë, shtëpizë
Lim – llamarinë
List testere (za masinsku testeru) - listë sharre
Liv – derdhje, derdhurinë
Livnica – shkritore, fonderi
Loptasta osovina – aksi sferik
Ložac – zjarndezez
Luk - hark
Lupa – thjerrëz zmadhuese, llupë

Lj

Ljuljanje - lëkundje
Ljuljačko - kolovajzë
Ljuštanje - lëvorëzim, të qëruarit

M

Magacioner – magazinier, depoist
Makaze – gërshërë
Matica –burmak, bulon
Mašina za ispitivanje – makinë për ekzaminim
Matrice- amzëtore
Mazalice (ručne) – lyrësore dore (grosatore), lubrifikant
Medjuploča – mespllaka
Medjustepeni – messhkallë (e lirë)
Mehur - mëshikëz
Mekeçelusti – nofull e butë
Meraç- matës
Metalna korpa - shtalka
Metalni ram nosaç – kornizë bartëse metali
Mirovanje –qetësueshmëri
Montaža priključnih elemenata – montim i elementeve bashkëngjithëse
Montaža polužnih amortizera – montimi i asmortizatorëve me levë

N

Nabijač - shtypës
Nabijanje – shtypje me ntrusje
Najlonske vrećice (kesice) - thasë (qeska) najlloni
Naleganje - mbështesë
Nalepnica – etiketë (pusullë)
Namotač, kalem – bobinë
Nanos - fundërrinë
Nanošenje – aluvim, lysterje me gjuajtje
Napon, naprezanje – ndemë, tension
Naprava –t përdorëse (apara)
Naprezanje - soliditet
Naprslna - plasaritje
Nareckavanje –grizhëzim, gërricëzim
Narezivanje navoja – nxjerrja e filetës me mandrovidë
Nareznica – madrovidë (f), filetënxjerrëse
Navlačenje poklopca prahobrana – mveshja e kapakut të pluhurbrojtësit
Naslaga - shtresë

Natega - sifon
Navoj – filetashtjellës
Navrtanje - vidhosje
Navrtka – vidë (f.)
Navrtka donjeg ventila - dadoja e valvulës së poshtme
Navrtka klipa – dadoja e pistonit
Navrtka rezervuara – dadoja e rezervuarit
Nosaç koçione cevi – bartësi i gypit frenues
Nosaç opruge – mbajtësi i sustës
Nosaç zaptivke - bartësi i hermetizueses
Nožica podsklop – këmbëza nënbllok

NJ

Njihalica - lavjerrës
Njihalka - luhaçë
Njihanje - lëkundje

O

Obaranje ivica – rrëzimi i teheve (zmuzimi)
Obeleživač - shënuesor
Oblazac - shpinar
Oblikač - trajtëdhënës, trajtësor
Oblikovanje – formësim
Obrada - përpunimi
Obrtanje – strumbullim
Ocedjenje - përtharje
Ocrtavanje – skicimi
Odbacivanje - shkagim
Odbojni ventil – valvula repulsore
Odlaganje komada – pezullim i pjesëve
Odlivak – detal-derdhësor
Odkivak – prokat, përfitimi nga produkti i gatshëm
Odmašćivanje - çyndyrëzim
Odmotanje – shtëllisje, mveshje
Odsečanje – prerje, këputje
Odstupanje – tolerim

Odvijanje - zhdredhje
Odžarivanje - ndajngrohje
Ograničivač – përkufizues
Okretač - ndërlëvizës
Okruglo brušenje – qostërimi qarkor
Opasač – rryp-brezi
Opiljci -bluzhdurina
Opravka – riparim
Opruga – spirale, sustë
Opruga klipa – susta e pistonit
Opružni podupirač – çandër sustore
Opticaj - qarkullim
Opterečenje - ngarkesë
Oribanje – grirje, spastrim
Osigurač-čep – sigurues me tapë
Oslona ploča – pllaka mbështetëse
Osovina –aksi, boshti
Osvajanje tržišta – pushtim i tregut
Osvojnica - spinota
Ozublivanje i formiranje konusa – Dhëmbëzimi dhe formimi i konusit
Otkivak - detal-farkëtimor
Otprema –ekspedim
Otvor – vrima
Oznaka - shenja
Označavanje - të shënjuarit

P

Parni kotlovi – kazanat me avull, kaldajat
Perač delova – larës i pjesëve
Peskovanje – rërëzimi (ranëzimi)
Pipak – pipth, prekël
Plin -gaz
Pločica – pllakëza
Plovak – pluskuesor
Podloška zaptivke – rondelë, nënvënëse hermetike, përfundëse
Podmetač – rondelë, mbështesë
Podsklop - nënblok
Podupirač – çandër, tërthorak

Pogon - fuqi lëvizëse
 Pohabanost – përdorueshmëri e konsumuar
 Pojaçavanje vara - përforcimi i tegelit (saldit)
 Poliranje - shkëlqësim
 Polirnica –shkëlqimtare
 Poluga - leva
 Poluga sklop – levë bllok
 Poluproizvod – gjysmëfabrikat
 Polutka -gjysmunazore
 Polužni amortizer – amortizator me levë
 Pomagale – vegla ndihmëse
 Pomak - ushqim
 Pomično merilo – matje me nonus
 Poranjavanje – nivelizim, rrafshim
 Poravnjivač – rrashuesor, rrafshor
 Posmak – thellësiprërjeje
 Potiskivanje - përshtyrje
 Postolje stolice - korpus karrigë (pedestal)
 Postupno izvlačenje – lehtënxjerrje me shkallë-shkallëzim
 Potočno postrojenje - instalim rrjedhës
 Pouzdanje – konfidencë,
 Pouzdanost - sigurimësi
 Povrljivost –rezervatshmëri
 Površina – suprina, sipërfaqe
 Povratni hod – ecje me kthim
 Poziociona pločica - pllakëza pozicionale
 Prahobran - pluhurbrojtës
 Prečnik – perimetër, përmasë
 Prekidač –komutator, çelës ndëprerës
 Preklop - përputhje
 Premeštanje, pomeranje – tejbartje, spostim
 Prenosna osovina – aksi tranmetues
 Prestup –delikt, kundravajtje
 Prevlaka - cipë
 Pribor - veglëri
 Prigušivač - fikatës
 Priključak – vendlidhje
 Priključnica - ndërlidhëse
 Prilaz rolni – qasje ruli
 Primicanje –odmicanje – ardhje-vajtje (afrim-largim)

Pritezanje navrtka klipa - përshtrëngim i dados së pistonit
Pritezaç - shtrënguesor
Pritisak - trysni (ajri)
Privlaçenje – tërheqje
Probijanje - depërtim
Produžni šiljci – bizat e zgjatuara
Proklizovanje gumene čaure - rreshshqitja e gomë-bokollës
Prolaz - kalesë
Propeler - helikë
Propustljivost – depërtueshmëri
Prosecanje - preje me këputje
Prosekaç – prerësor
Prorez - prerëz
Proširivaç - zgjeruesor
Protočna-kada - vaskë rrjedhëse
Provlakačica- vegël përshkuese
Provlaçenje - përshkimi
Provlaçeni cilindri – cilandrat përshkues
Prstenasta elastična ploča – nënvënçsja unazore elastike
Pucvalt - cuklurina

R

Radilica- kollodok (boshti i kushinetave)
Radno vreteno – boshti (shpinella) e punës
Rajbovanje – ngujim, rajbim
Ram - kornizë
Račva (štelajuča/kontrolna) – degëzor, kalibër kllapë (stellues/kontrollues)
Račvaska osovinica – spinota degëzore
Rascepka – çarje, copëzim
Raspored – orarëzimi i përndarjes
Rasporedjivanje - përndarje
Raspodela – shpërndarje
Rastavlač - ndërprerës
Rastvor - tretësirë
Razrada – hartim
Razradjivac - rrallues, tretës
Razvijanje – shtëllisje, zhvillim
Razvlaçenje amortizera – zgjatjezim amortizatori

Razvnatavanje - kalizvaritje
Razvodni ormani – dollapë shpërndarës
Regulacioni broj – numri i regullacionit
Regulator posmaka – rregulluesi i ushqimit të lëvizshmeriosë
Remenica – rrotulla
Remont – rimont, riparim (ndreqje)
Rendisanje – zdrukthëtim, zdrugim
Rešetka – grila
Rezač – prerës
Rezanje-navoja - punimi i filetës
Rolna – ruli
Rolovanje - rulim
Rubni karton - anekskartelë
Ručica - dorëza
Rukavac – perni
Rupa – bira, vrma

S

Sabijanje – ndrydhje, trusni
Sanduk – arkë
Sastavak – komponente
Sastojak – përbërje
Savijanje (kružno) – epje rrethore, përkulim
Segmentna opruga – susta segmentore
Sekuće ploče – pllaka të prera
Semering zaptivke – semerin hermetizuesi
Sila savijanja – trusni-anëlakimi
Silan-blok – blloku i fortë
Sinterovano gvoždze – hekur i sinteruar
Sirovnost – shtalbësi
Sisač – aspirator, thithësor
Skidanje pipka – heqja e pipthave (preklave)
Skidanje pucni – largimi i gërricave
Sklop poluge - bllok me levë
Sklop /presovano/ labav/ prelazan – lidhje /e forte/ e lire/ kaluese
Skidanje zavojnog dela – heqja e pjesës filetore
Skretanje –shmangie
Slaganje – stivim, rradhitje
Slavina – pipa, musluk

Sloj – shtresë
 Složenost - ndërlikueshmëri
 Službenost - servitudë
 Smicanje – shkëputje terthore
 Snimanje – incizim
 Snop elektrosnop - tufël, elektrotufë
 Spoljna čaura – bokolla e jashtme
 Spojnica - xhunto, rrotull e përbërë
 Sporohodni transport – transport me shpejtësi të vogël
 Stablo – trupi, trugu
 Stakleno vuno – fiberglas, lesh xhami
 Stalak- këmbalkë
 Stega – shtrënguesor, mengele
 Stezna čaura – bokolla shtrënguese
 Stezna glava – koka shtrënguese
 Stinjavanje – pikasje, shtangim
 Stislivost — tkurrje
 Stolna bušilica - trapano (shpuesore) tavoline
 Straža – rojë
 Struganje – tornimi, zdugimi
 Struganje sa kopiranjem - tornimi me të kopjuar
 Strugotine – hime, bujashka, ashkla
 Stubna bušilica –shpuese shtyllore

Š

Šav - tegel, sald
 Šavna cev,- gypi me tegel
 Šeljak, smola – rrëshirë
 Šiljak - bizë
 Šipka - flugëza, shufër
 Šljak - zgjyrë
 Šmrkovanje - pompëzim
 Šoljica opruge donjeg ventila - tasi i sustës së valvulës së poshtme
 Šoljica zatvarač - kupa mbyltese
 Šopovanje - shopimi , gëdhendje
 Štelovane račve- degëzore pozicionale (stelluese)
 Štitnik lica – mbrojtës i fytyrës
 Štucne – kallçinj, gjunjëza

T

Tačkasto zavarivanje – saldim pikor
Tanjirič - pjatëz
Tanjirasta opruga – sustë pjatore
Tečnost amortizera – vaji i amortizatorit
Tekuči plan – plan rrjedhës
Teleskopski amortizer – amortizatori teleskopik
Terminer- terminer
Tesarenje - latim
Tesno navlačenje - vendosje me forcë
Točilo - toçillë
Toplo oblikovanje – formësim me ngrohje
Toplo pranje – larje e nxehtë
Toplovod - ngrohjesjellës
Traka - shirit
Trakasto testero - sharrë shiritore
Transportni sanduk – arkë transporti
Trn- punson, therre
Tupo varenje – saldim topitës
Turpija – lima
Turpijanje – limim
Tvrdoća- fortësia

U

Ubadanje - vrimosje
Ubrzanje - shpejtësim
Ubrizgavanje - gjilpërizim
Učinak - efekt
Udarač – mëshuesor
Udaranje - mëshuarje
Ugib plasnasti – epje e rrafshët
Uhodavanje –parapërgatitje, qasje
Uklapanje – perputhje, puthitje
Uključenje - përfshirje, lëshuarje në veprim
Ukršnjak – kryqëzues
Uleganje – humbim, ramje
Ulog štedni – konto kursimi

Umekšivač vode - ujëzbutës
Umetak - shtojcë (interkalacion)
Umetak (toplivi) – siguresë e shkrirshme
Upuštanje – të lëshuarit, lëshuarje
Uredjaj - pajime
Uredjaj za snicanje - pajisje për shkëputje
Ureznica - filetënxjerrëse
Usecanje - prerje
Usko grlo – fytrat e ngushtë, grykat e ngushta
Uskočnik – kërcyesor
Uslovi probe - kushtet e ekzaminimit
Usmerivač ulja – kahjedhënës i vajit
Uspon - termasirë, sipërpjetëz
Ušica – veshëz, bokollë
Ušica podsklop – veshëza nënbllok
Utikač – thumb, prizë
Utisnuče - shtypje
Uzemljenje - përtokëzim
Uzorak – mostër, gjedhe, kampion

V

Valjak – cilindër, rul
Valjanje – petëzim, shkalkëzim
Vara – saldi, tegeli
Varenje – saldatim, saldim
Variranje - vibrim
Vatrogasni apart – aparat zjarrfikës
Vazдушna kapa - shtupa ajrore
Ventil sa dva proreza – valvolë me dy çallata
Vijak donjeg ventila – buloni i valvolës së poshtme
Vijak - valvolë
Vijak šuplji – bulon fyell
Vijak goli – bulon pa kokë (prixhonjer)
Vihor – shtjellë, shtjellje
Viljuškar – vetëngarkuesi pirunor (autopirunor)
Vinkle - kllamfë
Visak sa ubušivačem – lavjerrës me turjelë
Vodeča ploča – pllaka udhëzuese
Vodovodni instalater – instalues ujësjellësi

Vodjica – udhëzuese
Vozač – vozitës, shofer
Vozilo - atomjet
Vratilo - shul (cilindër)
Vreteno – bosht, shpindëll
Vršno opterećenje – ngarkesë e majës

Z

Zaçepljivanje - shtupimi
Zahvat – kalim, kapje, qasje
Zakivak - ribatin
Zakočnik prese – fre torku (prese)
Zakrčen prolaz – pengim kalimi
Zakušivača –turjelë qendërzuese
Zamojac - volanti
Zaokretanje - rrotullim
Zaostajuće pomerenje - çfazim i vonuar
Zapremina - vëllim
Zaprljenost - ndohtje, ndytshmëri
Zaptivak – mbullësor, stopël hermetizimi
Zaptivka – guarnizues, hermetizuese
Zaptivni porsten – unazë hermetizuese
Zaribanje – pastrim me gërryerje
Zatezna çvrtstoća - qëndrueshmëri në tërheqje
Zatezanje - ndemje
Zaulivanje – undyrëzim, vajosje
Zavojna opruga – sustë spirale
Zavojc - pështjellëz
Zavojnica – helikë
Zavrtanj zatvarač – buloni mbyllës
Zavojno vratilo – boshti i vidhosjes
Zavšni kontrolor - kontrollues i finalizimit
Zazor –hapësirë (fyrbësinë)
Zglobljenje – nyjtësim
Zgrušavanje – kokërrzim, shkoklim
Zgura (šljak) – zgjyrë, zdrugulinë,
Zubčanik – dhëmbëzor, ingranazh
Zupčanik razvoda – dhëmbëzor i shpërndarësit

Zvezdasta opruga – sustë yllore

Ž

Žarenje – pjekje, prcëllim

Železnica - hekurudhë

Žica - tel, kabëll

Žigovanje - shtamposje, vulosje

Žičara - telefirik

Žleb – ulluk, gojkë

Žlebovanje - hullëzim me vana, shlizim

Žleborez - gardhnor

Žmigavci - anasinjalet në automjete

Pasthënie ose episod rreth historikut dhe të veçantave të këtij “Fjalor pune”

Në këtë **Pasthënie** flas pak më shtruar për vetveten, ndërlidhur me historikun e këtij **Fjalor pune dhe të veçantave të tij**. Flas për tri fazat: të lindjes, të formëzimit dhe të libërimit të tij.

Krejt e logjikshme, e para, pas pëndjekjeve, d.m.th. pas përjashtimit nga arsimi si mësues i shqipes që e kisha ideal punën me nxënës, e dyta, pas leçitjeve dhe izolimit pothuaj njëvjeçar pa kurrnjë të ardhure për jetë (deri edhe pa shtesë ushqimimi të 5 fëmijëve) dhe së treti, pas punësimit, larg nga shqipja, gati një vit, në Ndërrmarrjen e ndërtimit të rrugëve *Partizanski put*, të Beogradit, filala në Prishtinë, si referent (ku parashihej shkollë e mesme ekonomike, ndërsa unë i kisha të dhëna provimet e magjistraturës), pranimi im me konkurs si përkthyes i shqipes në administratën dygjuhësore në Uzinën e Amortizatorëve të Prishtinës, thjesht, për mua ishte një dritë shprese e çburgosjes që njëherazi mund të thuhet se fillon edhe një përlindje e vocërr apo faza e parë e shenjzimit të lindjes së këtij Fjalori. Në të vërtetë ky kalim në këtë Uzinë si përkthyes ishte një ngushëllim ose si një këmbëcë lidhce për ambicien e pashuar që kisha rreth mëkimit të shqipes, thesar ky më i shtrenjti i shqiptarisë, nga e cila shteti më kishte shmangur dhunshëm...

...Sidoqoftë, edhe pse kisha njëfarë përvoja në përkthim serbisht-shqip për arsye të specifikës së punëve në këtë Uzinë, patjetër nga nevoja e përkthimit në sirtarin e parë të tavolinës sime të punës, që në fillim u detyrova me i shënue disa fjalë-terma serbisht-shqip, pa njohjen e të cilave s'mund ta kryeja si duhet detyrën e re. Natyrisht si çdo punë edhe kjo kërkonte përveshje serioze. sepse këtu praktikisht nuk kishim të bënim thjesht me probleme të gjuhës administrative, prandaj nuk mjaftonte dija paraprake nga të dyja gjuhët, ngase patjetër imponoheshin edhe elemente terminologjike precize të gjuhës teknike-teknologjike. Kjo ishte arsyeja që jo pak fjalë-terma, nuk i ndeshnim në fjalorët e rëndomtë, andaj ata i vilnim ose i mësonim në mënyrë të ndryshme nga leksikone të fjalëve ndërkombëtare dhe patjetër si të tillë na duhej shënuar në notesin tonë.

Sidoqoftë, jo aq lehtë, por për një kohë të arsyeshme u tejkalua me sukses kjo fazë e parë e vështirësive dhe njëhazi ishte arritje e suksesshme në të kryerët e detyrës nga vendi i punës. Ishte i rëndësishëm fitimi i besimit i eprorëve dhe respekti i punëtorit, zot i punës së vet.

Fazë të dytë quajmë periudhën kur të tjerët ishin të kënaqur me ponën tone, por ne nuk ishim të kënaqur vetëm me përvetësimin sadokudo të zanatit të përkthimit lidhur me vendin e punës në zyrë, po kërkonim më shumë.. Kështu përveç konsultimit të literaturës përkatëse vazhduam konsultimin me kuadrin inxhiniero teknik shqiptar e serb si dhe me punëtorët nga prodhimi i drejtpërdrejt për t'i kuptuar më mire proceset teknologjike që duhej t'i emërtonim shqip. Meqë me disa individë të personelit udhëheqës të punësuar aty njiheshim më përpara nga shkolla e mesme teknike (shqiptarë e serbë) nga konsultimi me ta kishim përfitim të ndërsjellë. Dhe si rrjedhojë ndërkohë skicuam një fjalor intern, me të cilin gjenim shkas për konsultime e procedure të mëtejshme. Kështu ndërkohë pothuaj arritëm të përvetësonim, madje edhe të rekomabdonim serbisht e shqip në emërtimin e disa nga nocioneve të proceseve tekniko-teknologjike, por edhe të ndërhyenin qoftë drejtshkrimisht ose në gjetjen e emërtimeve përkatëse barasvlerëse sidomos në gjuhën shqipe, qoftë edhe me kalkëzime dhe kështu pothuaj arritëm në njëfarëdore të zbatonim të drejtën kushtetutare rreth barabarësisë së gjuhëve edhe në këtë ndërmarrje. Dhe si burim konsolidues tashti na shërbente fjalori intern yni dygjuhësh, të cilin e pagëzuam **Fjalor pune/Poslovni rečnik**. Në këtë fazë i lëshuam krahe ambicies për të ndihmuar sadopak jo vetëm *klasën punëtore* të ndërmarrjes sonë, por edhe më gjerë në ndërmarrje të tjera ku shqipja duhej përdorur ligjërisht barabar me serbokroatishten, por edhe vetëpërvetëm.

Këto janë pak a shumë ato moment-komponentet kur mund të themi se nga faza e dytë fillon ambicia për të kaluar në përhartimin ose hapërimin nga faza e dytë në fazën e tretë të historikut të këtij *Fjalori pune*, sepse duke bërë krahasimet përkatëse, në rrafshin e gjuhës standarde shqipe dolën sheshit gjëra të diskutueshme, madje edhe përfitime të gabueshme të shqipes te ne. Sidoqoftë, në këtë fazë morëm guxim të shfaqnim mendimin tonë rreth atyre çështjeve problemore. Dhe për fat disa nga ato shkrime tona gjeten publikim në mjetet e informimit publik. Nga një përthellim i tillë pak nga pak krahas trajtimit ose paraqitjes publike të problemeve të kësaj natyre e përplotësonim edhe vetë Fjalorin. Kështu pra, pasi e plotësuam paksa me lëndë të re Fjalorin në versionin shqip serbisht për nevoja interene të Uiinës e shaptilogruam. Dhe ekzemplarë të këtij Fjalori u shpërndamë jo vetëm punëtorëve shqiptarë e serbë të interesuar brenda Uzinës, por edhe në mbi 100 e sa personave jashtë, duke përfshirë edhe institucionet si Institutin

Albanologjik, Fakultetin teknik të tri Degëve, të Elektros dhe të Makinersë dhe atij të Ndërtimtarisë, duke kërkuar nga kuadri i tillë përkatës vlerësim e bashkëpunim. Pikërisht këtë material nga Fjalori e shfrytëzoni duke e cituar si burim konsultues në dhjeta e dhjeta punime e artikuj përkatës të publikuar prej nesh. Ç'është e vërteta, pikërisht në këtë periudhë mjaft dinamike, që nuk ishte edhe aq e shkurtër, meqë problemet e tillë ishin me interes jo vetëm në nivel Kosove (Jugosllavie), por edhe më gjerë, përplotësisht të këti Fjalori pune i kushtuam më shumë përkujdesje, por tash mbi bazë shoqërore nga kuadrot, të cilëve u patëm dorëzuar ekzemplarë të Fjalorit konkretisht kërkonim që të inkuadroheshin, përkatësisht të vlerësonin qëndrueshmërinë, e zgjidhjeve tona në shqipe, por edhe të shtonin emra konkretë të pajisjeve ose emërtime teknike-teknologjike të kësaj natyre që nuk ishin në fjalorin tonë, por që aty e kishin vendin, sipas këtyre fushave semantike:

1) rreth emërimit (titullimit) të ndërmarrjeve, përkatësisht formave organizuese në kuadër të ndërmarrjes apo institucionit përkatës;

2) emërtesat e profesioneve (nomenklatura) e profesioneve sipas organikave;

3) rreth termave teknikë:

a) emërtimi i mjeteve të punës, veglave, përdorësve etj.,

b) emërtimi i pjesëve të mjeteve të punës, veglave, përdorësve etj.

4) emërtimet e proceseve tekniko-teknologjike dhe

5) terma përkatës nga fusha të tjera me interes.

Nuk e fsheh, dëshironim që sikurse në fushën juridike dhe atë ekonomike që autorë të caktuar kishin provuar të publikonin me sukses fjalorë përkatës terminologjikë serbisht–shqip, të inicionim që kështu të vepronin edhe ish-nxënës ose kolegë të mi nga Shkolla e mesme teknike të Prishtinës, të cilët tani pak a shumë kishin kryer specializime përkatëse dhe zinin poste udhëheqëse në ndërmarrje e institucione të ndryshme e sidomos në fakultetet përkatëse në gjuhën shqipe, me të cilët doja ta shtrijs bashkëpunimin rreth harmonizimit të terminologjisë në raport Shqipëri – Kosovë (ish Jugosllavi), por mjerisht kjo nuk ndodhi.

Sidoqoftë, unë vazhdova të trajtojë tema po nga këto fusha të sipërcekura (teknike) me qëllim kishim: harmonizimin e terminologjisë teknike në suazat e gjuhës shqipe, natyrisht, duke aluduar në në termat që përdorëshin në Shqipëri të shtrihen edhe te ne dhe si rrjedhojë veç tjerash vazhdoja ta citoja edhe këtë Fjalor si burim. Më kujtohet një rast, pas leximit të një kumtese të kësaj natyre në një Konferencë shkencore (1982), të organizuar në Institutin Albanologjik, drejtuesit e Konferencës të prirë

nga prof. Kostallari, ndër të tjerë edhe prof. Mahir Domi, prof.. R. Qosja, profI. Ajeti, etj. më nderuan, duke më uruar me shtrirje dore, ngase si duket ishte hera e parë që një gjuhëtar trajtonte lëndë të tillë nga fusha e gjerë e tekniko-teknologjisë dhe njëherazi u interesuan për atë Fjalor. Unë u përgjigja se ende është në skeda, por gjithsesi atë do ta publikoj, siç e lyp rendi, vetëm pasi të plotësohet me lëndë të re plotësuese, qoftë nga ndërmarrje të tjera të Kosovës, qoftë nga Shqipëria, konkretisht nga *Uzina Traktori të Tiranës*, qoftë nga uzinat e *Kombinatit Çeliku i Partisë* – Elbasan. Ku kërkoja të shtrihet studimi. Me këtë nuk e fsheh që për hir të rëndësisë studimore që ushtroja si doktorand, student pasuniversitar kërkoja disi të më mundësohej vizita në Shqipëri me qëllim studimi, edhe pse e dija se kjo ishte e pamundur. Në të vërtetë, prof. Kostallari, pasi më njihte për interesimet tona dhe më vlerësonte më parë si student pasuniversitar, e kishte provuar një mundësi të tillë pa sukses që edhe tema ime të përfshihej në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim ndërshtetëror etj. Është interesant se ndërkohë, kur shfrytëzoja rastin ta takoja kalimthi, kur ia dorëzoja disa libra të IA, në korridor të hotelit “Bozhur”, lidhur me këtë, ai më njoftoi shkurt:

Nuhi, për të fituar ndonjë privilegjë shpeshherë ndodh që duhet shërbyer edhe me 99 kryqa të huaj, por kryqin tënd duhet ruajtur gjimonë për fund, por t'i gjithsesi bashkëpunoj me prof. Idrizin, se mund të bëhet mirë.

Kështu pra, edhe pse lidhur me fjalorin përpunimin e përplotësimin e tij nuk pata asnjë përkrahje nga askush, madje as morale nga dikush-dikushi, megjithatë unë nuk pata hequr dorë nga përgatitja e tij si vepër që herdokur mund të libërtohej, prandaj vazhdimisht, e kam pasuruar, me lëndë të re kryesisht po nga ato fusha të gjera teknike të sipërcekura. Këtë e dëshmon edhe materiali i botuar më parë dhe në librat tona të fundit.

Meqë Uzina e Amortizatorëve në atë kohë kishte bashkëpunim ekonomik me shumë shtete e ekonomi europiane, por ndër të tjera si më e njohur ishte Franca, pasi në këtë Uzinë prodhoheshin me sukses amortizatorë e pajisje të tjera për Pezho, Reno e Citroen, madje flitej edhe për zgjerim bashkëpunimi, andaj në këtë Uzinë ishin të punësuar tre përkthyes simultantë shqiptarë (për frengjisht-serbisht-shqip), kështu edhe ne bashkëpunonim me ta shoqërisht dhe në këtë kontekst më lindi ideja që hartimi i këtij *Fjalor pune* gjithsesi duhej të përgatitej sipas tipit shifror, por që teksti themelor, patjetër duhet të jetë ai shqip, dhe përveç barasvlerësve serbokroatisht që do ta bëja unë, të pajisej edhe me tekstin frengjisht, mbase edhe rusisht, anglisht etj., prandaj siç po shihet lënda e

këtij fjalori përfundimisht është hartuar në bazë sipas procedurës së tipit shifror, edhe pse ende versioni me shifrimik në serbisht për mungesë kohe e organizmi nuk është kryer.

Është e vërtetë se për shkak të rrethanave politike, nuk ishte i lehtë bashkëpunimi ynë me të tjerë, por edhe i të tjerëve me mua. Ndërkohë gjendja politike u keqësua edhe më tej. Ndodhi mohimi i autonomisë së Kosovës, përjashtimi i punëtorëve shqiptarë nga prodhimi, pastaj mbyllja e shkollave shqipe deri edhe shpërthimi i Luftës për Çlirim dhe Çlirimi i Kosovës, Fjalori mbeti dorëshkrim, jo plotësisht i përgatitur...

Pas Çlirimit të Kosovës 1999, kur u kthyen në këtë Uzinë kryesisht vetëm punëtorët e përjashtuar shqiptarë, jo menjëherë por pas 3-4 vitesh dikuj nga stafi drejtues i kësaj Uzine u shkoi ndërmend (më 2003 që ky Fjalor dygjuhësh duhej punuar (edhe pse serbishtja tash nuk praktikohet, por ishte e rishpallur si gjuhë zyrtare e shtetit të ri Kosovës. Atëherë më ftuan për ta rirregulluar Fjalorin.. Me insistimin e tyre vullnetarisht e kompjuterizova. Shpresoja se si të tillë, siç më patën premtuar, do ta libërtonin, po kjo nuk ndodhi sepse, fatkeqësisht kjo ndërmarrje metal-përpunuese falimentoi dhe si e tillë po thonë është shitur si plaçkë e privatizuar(!).

Sido që të jetë, meqë edhe këtë Fjalor e konsideroja, siç është në të vërtetë, si veprat e tjera shkencore studimore të mia, edhe pse nuk munda ta përkryeja, siç e pata planifikuar, vendosa ta libërtoja, e cila kërkon të vlerësohet jo vetëm për rëndësinë dokumentuese që ka si vepër e krijuar në një kohë-hapësirë të caktuar, po së paku edhe për këto të veçanta që i ka:

E para, vetë titulli **Fjalor pune /Poslovni rečnik**, jep për të kuptuar se fjalori është ndërtuar si dygjuhësor, por ndryshon nga fjalorët e tjerë, ngase ka të bëjë me një tip të veçantë. Fillimisht e përgjithësisht kishte të bënte parësorisht për nevoja menagjimi të zyrës së përkthimit konkretisht të një ndërmarrje të vetme: Uzinës së Amortizatorëve të Prishtinës, si ndërmarrje metal-përpunuese (në një kohë të caktuar të administratës dygjuhësore shqip-serbisht), por sa i përket terminologjisë ka fituar tipare përgjithësimi edhe për ndërmarrje e institucione të tjera.

E dyta, edhe pse gjuha serbokroate për ne na atë kohë faktikisht ishte si *lingua franca*, ngase imponohej me terminologji të konsoliduar, ndërsa shqipja pathuaj në mjaft raste nuk njihej te ne ose ishte në konsolidim e sipër, ne i dhamë përparësi shqipes dhe këtë Fjalor e hartuam përfundimisht me gjuhë themelore shqipe sipas tipit shifror, por duke lënë vend për shtimin e versioneve të gjuhëve të tjera jo vetëm të serbishtes por edhe të gjuhëve të tjera që mund t'i bashkangjiteshin të sqaruara me shifrim sipas termit të shënuar në tekstin themelor të shqipes.

E treta, në tekst janë shënuar në shqipe e në serbishte (jo mbiemrat, ndajfoljet dhe foljet), por tërësisht vetëm fjalë-terma përkatës në cilësinë e emrit të mirëfilltë, përkatësisht të prejpjesorëve përkatës të shqipes.

E katërta, ka zgjidhje në gjuhën shqipe, që janë si me thënë përftime të rastit ose ndonjëra gjetje të vetë autorit, prandaj mund të ketë edhe fjalë-terma të diskutueshëm, por gjithsesi jo të qortueshëm, ngase janë formuar, sipas natyrës së gjuhës shqipe, strukture fjalëformuese të saj.

E pesta, në zërat përkatës janë dhënë mjaft sinonime në të dyja gjuhët, kështu që shfrytëzuesit i mbetet të përzgjedhë atë fjalë-term që i përgjigjet natyrës së materialit të caktuar me të cilin manipulon;

E gjashta, janë respektuar risimet ose prirjet e caktuara lidhur me shqipen që mund të jenë hetuar, në atë kohë, nga studimet e publikuara të autorit dhe jo vetëm të tij, por që edhe prirja e sotme e arsyeson atë rrugë prirjeje, siç janë:

1) emërtimet e vendshërbesave më -TORE, tipi: *vegëltore, ngjyrëtore* etj.;

2) emrat e mjeteve më -ore, -ës, -cë, -ëz/ë etj. tipi, *veglore, afatore; matës, fërkojcë, arkëz, kutizë* etj.;

3) konceptet në raportin formimet me prapashtesën -Ë në kundërvënie (si emra konkretë ndaj atyre me prapashtesën -JE (si prejpjesorë me kuptim procesi), tipi *mbështesë/mbështetje, masë/matje; djegë/djegje, dredhë/dredhje, pjekë/prekje* etj.;

4) emërtimi i proceseve në raportin proces i thjeshtë më -IM ndaj atij kimiko-teknogjik me -ËZIM, tipi *thartim/thartëzim* (acidifikim); *gëlqerim/gëlqerëzim* etj.;

5) emërtimet më: -i, -si, -shmëri etj, tipi: *rregulli/rregullsi, rregullshmëri e rregullueshmëri, ashpëri /aspërsi ashpërimsi* etj. - për ngjyresa të ndryshme semantike tekniko-teknologjike.

6) për t'i ikur homonimisë në raportin *emërtim vegle të thjeshtë më -OR ose -ORE ndaj emërtim njeriut sipas profesionit ndaj / emërtim pajisjeje të specializuar*, autori përparësi i jep emërtimit të njeriut formuar nga prejpjesori me fundoren -ue/s ose -ës, ndërsa emërtimit të mjetit a pajisjes përzgjedh trajtën me -OR, përkatësisht -UE/SOR.

Krahaso shembujt:

- *izulor, zbulor, shënor, përcaktor, rregullor, dredhor* (mjet)

ndaj

izolues, zbulues, matës, shënues, pyetës, përcaktues, rregullues, dredhës (njeriu sipas profesionit)

ndërsa

izoluesor, zbuluesor, matësor shënuesor, pyetësor, përcaktuesor, rregulluesor, dredhësor (pajisja e psecializuar), e kështu me radhë;

7) në raste të rralla, ashtu si janë ndeshur në burime të caktuara bëhen dallime semantike, sipas ndonjë trajte në raportin *rotacizëm /jorotacizëm* ose *letrarishte e sotme /gegërishte*, si b. f.: *emnim* (nomimin) ndaj *emërim* (caktim), *lyes / lyerës, tharbëtim/ thartim, uror/ unor, varrim* (varrë- plagë), ndërkaq *vorrin (varrosje), zanc / zënës, zjarmi/ zjarr* e ndonjë tjetër;

8) disa huazime mjetesh nga italishtja si *perni, xhunto, parafango* etj. janë shënuar, disi pa dëshirë, pasi mendohet, për çka lypset verifikuar, se për to, jo vetëm te ne që ishin të panjohura, por mbase edhe në Shqipri mund të jenë përfutuar në vend të tyre sinonime mbi bazë të fjalës shqipe, të cilat mund të jenë më të përshtatshme, apo jo?!

9) krahas disa fjalëve ndërkombëtare janë shënuar neologjizma, si: *disocim – shpërbashkim, difuzion –shpërhapje, dirigjim – përdrejtësim* etj.;

10) Gjithsesi nga autori parapëlqehen trajtat hibride në vend të huazimeve të mirëfillta (transfer) si p.sh: *axhustator –axhustues, montator – montues, frezator – frezues vullkanizer – vullkanizues, servir - servues* etj.

11) në fund po sqaroj se Shtojca serbokroatisht shqip është bërë, vetëm për shkak se lënda e tillë rastësisht nuk ka mundur e tëra të sistemohet më parë në tekstin themelor të shqipes për mungesë kohe, moshe etj, prandaj lëndën e tillë prej mbi 2000 shembujve e shënuam sipas versionit serbokroatisht–shqip. Edhe këtu basrasvlerësit në shqip janë në numër më të madh për shkak të shumësisë së sinonimeve përkatëse.

12) Si të veçanta, në fund po i shtojmë edhe këto dy fakte që po i shprehim me pyetje që mbase nuk do të jenë aspak të rënda për t'u kuptuar qëllimi i tyre:

E para, a do të na besojë kush sot e nesër, që ne kemi punuar pa u lodhur me vetiniciativë pa pagesë fare, jo vetëm në hartimin e libërimitin e këtij Fjalori pune, por edhe për afro 20 vepra të tjera, i motivuar vetëm e vetëm për respekt e dashuri që ndjenim ndaj gjuhës shqipe, si thesari më shtrenjtë identifikues i shqiptarisë.

E dyta, vallë, a do të përpiqet kush në të ardhmen, në situatën, siç ishim ne, të hartojë ndonjë fjalor pune të ndërmarrjeve përkatëse metal-përpunuese e të tjera me vetiniciativë sipas tipit shifror me theks terminologjia tekniko-teknologjike, duke respektuar shqipen si gjuhë themelore?!

Ka edhe të veçanta të tjera që vëzhguesi i vëmendshëm mund t'i ketë hetuar, të cilat autori i ka trajtuar më gjerësisht në punime të veçanta të përfshira në veprat e tij t[b otguara ose jo.

Çfarë të them në fund, kush ka faj që ky Fjalor pune, nuk mundi me u plotësue me lëndë qofta nga *Uzina Traktori* e Tiranës apo *uzinat e Kombinatit Çeliku i Partisë i Elbasanit*. Kush mund të fajësohet pse sot nuk ekzistojnë as njëra as tjetra nga këto ndërmarrje?! Fundja nga Uzina “Amortizatorët e Prishtinës ka mbetur ky Fjalor pune, ndërsa nga uzinat e Shqipërisë nuk dime, ka mbetur, apo jo, ndonjë punim rreth terminologjisë së përdorur atbotë, në mënyrë që terminologjia e tillë të shfrytëzohet për procese të ngjashme në të ardhmen. Fundi i fundit ekziston shpresë apo jo në rivitalizimin e Uzinës Amortizatorëve të Prishtinës, apo ka mbetur kujtim për të vetëm ky Fjalor pune?

Ne krenohemi sot me dy shtete tona shqiptare sovraane, por e dime se këto nuk mund të ekzistojnë sovraane të plota si duhet pa industri, pa fabrika e uzina rentabile, pa gjuhë shqipe, pa terminologji përkatëse të moderuar. Me të cilën duhet të manipulojnë apo jo? Gjithsesi kemi të drejtë të meditojmë e shpresojmë se fati i terminologjisë shqipe varet prej edukates e vetëdijes kombëtare të pasardhësve tanë. Urojmë, pra, që pasardhësit tanë të kenë më shumë fat dhe më shumë suksese se ne në të gjitha fushat e jetës e të veprimtarisë edhe në fushën e terminologjisë teknikoteknologjike e shkencore.

Sidoqoftë, ndoshta, në një situatë më të ngeshme krejt lënda e këtij Fjalor pune, mund të përpunohet. Në fund kërkojmë kërkojmë ndjesë e falje për të metat që na kanë shpëtuar, njëherazi kërkojmë mirëkuptimr pse nuk mundëm me punue edhe më shumë.

L i t e r a t u r a :

1. Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore (1-15), USHT, Prishtinë 1970.
2. Fjalor shqip-serbokroatisht (m. ndreca), Prishtinë 1970.
3. Fjalor serbokroatisht - shqip (IAP) 1974 , ribot./1986.
4. Fjalor shqip- serbokroatisht (IAP), Prishtinë 1981.
5. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.
6. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 1984 , ribot. 2002.
7. Fjalor terminologjik serbokroatisht –shqip,, Prishtin ë 1979
8. Fjalor i terminologjisë ekonomike (H. Gorani), Prishtinë, 1973.

Të dhëna bio-bibliografike për autorin



I.

Nuhi (Muharrem) Veselaj u lind në fshatin **Reçan të Therandës** (ish-Suharekë) më 20.08.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948), Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.06.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 03. 09.1959 në Prizren. Shkollën e lartë, përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës – Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.09.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe, më 23. 11. 1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 03. 04. 1980 mori gradën: *magjistër i shkencave filologjike*, ndërsa *tezën e doktoratës e mbrojti* më 24.12.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qendër në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës. Është Anëtar Nderi i SHAK “Elena Gjika Dora d’ Istria, Therandë.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por për moszbulim provash nga ai, u dënua vetëm 2 vjet. Pasi doli nga burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të ripunësohej në arsim që e kishte ideal

veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës (8 herë): Mushtisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejçec (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Zllatar, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur për motive politike iu ndalua puna në arsim e organizata shoqërore-shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në Ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put* të Beogradit – dega në Prishtinë, prej nga kaloi në *Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës*, përkthyes. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai përkundër pengesave e përndjekjeve, me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, arriti të korrë suksese, qoftë në jetën arsimore e shoqërore-politike, qoftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, gjetën strehim e shërim ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij qe objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë eksodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shkojë drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllloboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dekada, pasi, përkundër tentimeve, atij i qe ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë, ky pasi e bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t'i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut, kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyra të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest buroteknik. Ndërkohë kreu me nder çdo angazhim që iu besua, por nuk u ekspozua në parti politike, më tepër u përqendrua në veprimtarinë krijuese.

II.

Nuhiu është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s'ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashti botoi këto vepra:

1) Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylberta (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;
3. Me buzët në gaz (vjersha për fëmijë), Iliriku, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), Iliriku, Prishtinë) 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), Iliriku, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), Iliriku, Prishtinë 1997;
7. Shfrime nëpër mjegullnajë (reflekse poetike e mendimore), Iliriku, Prishtinë 1997;
8. Mësime nëpër pësime (shfaqje teatrore), Iliriku, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), Rozafa, Prishtinë 1998;
10. Bulëza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), Rilindja, Prishtinë 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), Rilindja, Prishtinë 2000.

2) Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Rilindja 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O – në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002;
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006,
5. Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktrate) MASHT e RK-së, Prishtinë 2014,
6. Rreth identitetit të gjinisë asnjane në shqipen e sotme, Era, Prishtinë 2015,
7. Shumësi dhe shquarsia e emrave në shqipen standarde, Era, Prishtinë 2015,
8. Drejt standardizimit të gjuhës shqipe, Era, Prishtinë 2015,
9. Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, Era, Prishtinë 2015,
10. Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II, Era, Prishtinë 2015.
11. Çështje të shqipes standarde rreth 28 temave të diskutueshme, III, Era, Prishtinë,
12. Çështje të shqipes standarde rreth emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë IV, Era, Prishtinë,

13. Çështje të shqipes standarde rreth disa termave nga fusha e teknikës dhe e ekonomisë V, Era, Prishtinë,
14. Çështje të shqipes standarde rreth vendbanimeve, VI, Era, Prishtinë,
15. Fjalor pune (poslovni rečnik) shqip –serbisht, për ndërmarrjet meta-përpunuese – me theks terminologjia tekniko-teknologjike VII, Era Prishtinë,

Sidoqoftë, edhe pse në moshë të shtyrë (ec n; 84-shin)) pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha e gjuhësisë, qoftë nga fusha letrare-artistike, për libërtimin e të cilave qëndron në pritje mirëkuptimi nga institucionet dhe organizmat përkatës të qeverisë sonë, por edhe prej sponsorizuesve eventuale vullnetmirë.

Prishtinë, gusht 2016